Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2022



Shkup, 2023

Botues:
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Lektor:
Ahmet Selmani

Dizajni dhe rregullimi teknik:
Mr. Llazo Matovski

Shtypshkronja:
GRAFO PROM SHPKNJP - Manastir

Tirazhi: 300 copë

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 7

PJESA 1 8

1.1. Hyrje 8
1.2. Historia e AZGJ-së 9
1.3. Misioni dhe vizioni 10

PJESA 2 11

2.1. Statusi 11
2.2. Udhëheqja 11
2.3. Kompetencat ligjore të AZGJ-së 11
2.4. Parimet dhe vlerat e punës 12

PJESA 3 13

3.1. Vendosja organizative 13
3.2. Burimet njerëzore 15
3.3. Struktura e të punësuarve 17

PJESA 4 20

4.1. Pasqyra e punës 20
4.2. Përkthimi dhe lekturimi 21
4.3. Pyetësorët anketues 22
4.4. Regjistri (baza e të dhënave) 26
4.5. Trajnimi për përkthyesit dhe lektorët e sektorit publik 27
4.6. Trajnimet për të punësuarit në AZGJ-së 29
4.7. Parashtresat 32
4.8. Informimi 32

4.9. Buletini mujor 33
4.10. Ueb-faqja zyrtare dhe mediet digjitale 34
4.11. Fjalori elektronik VERBIS 35
4.12. Botimet e shtypura dhe ato elektronike 36
4.13. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit 37
4.14. Pasqyra e akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 40

PJESA 5 44

5.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi 44
5.2. Furnizimet publike 47

PJESA 6 48

6.1. Pasqyra e aktiviteteve të realizuara 48

REKOMANDIME 196

PARATHËNIE



Para jush është Raporti i Katërt Vjetor i punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AZGJ) për vitin 2022. Ky dokument paraqet një pasqyrë dhe kornizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të realizuara të AZGJ-së në përpjekjet e saj për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimin e kapaciteteve profesionale të institucioneve për përkthim dhe lekturim, si dhe mbështetjen e tyre në nivelin qendror dhe lokal, për të mundësuar realizimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve.

Krahas restrikcioneve buxhetore që ndikojnë në mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve për realizimin e aktiviteteve zyrtare, përsëri AZGJ-ja edhe në vitin 2022 arriti me një intensitet të pashuar të realizojë një sërë aktivitetesh në aspektin e kryerjes së kompetencave të veta ligjore. Krahas faktit që Republika e Maqedonisë së Veriut ka legjislaturë të avancuar, me të cilën rregullohet përdorimi i gjuhëve në sektorin publik, prapëseprapë, gjatë zbatimit të saj, shfaqen vështirësi dhe sfida, që tregon se ka nevojë për angazhim të vazhdueshëm me përpjekje dhe punë të përbashkët deri në arritjen e qëllimeve të caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, e ato janë promovimi, mbrojtja dhe zbatimi i njësuar i gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe).

Në vazhdim mund ta lexoni raportin, në të cilin është dhënë pasqyrë gjithëpërfshirëse për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, me rekomandimet përfundimtare për zbatim më efikas dhe efektiv të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. AZGJ-ja do të vazhdojë me realizimin e aktiviteteve të saj edhe në vitin 2023, për arsye se angazhimi ynë është që të realizohen të drejtat gjuhësore të qytetarëve dhe, besojmë se, bashkërisht do ta arrijmë qëllimin e përbashkët drejt ndërtimit të shoqërisë së qytetarëve të barabartë.

Me respekt!

Prof. dr. Ylber Sela,
drejtor

PJESA 1

1.1. Hyrje

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut[1] (në tekstin e mëtutjeshëm: AZGJ) është themeluar në pajtim me ligjin, në cilësinë e personit juridik, e që është kompetente për standardizimin dhe njësimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Raporti vjetor i punës ka të bëjë me periudhën 1.1.2022 deri më 31.12.2022 dhe është përgatitur në bazë të nenit 18, paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 7/2019), sipas të cilit AZGJ-ja për punën e saj dorëzon raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së paku një herë në vit, deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Raporti përmban rishikimin e aktiviteteve të AZGJ-së në zbatimin e kompetencave të saj ligjore, me qëllim që të realizohen të drejtat gjuhësore të gjuhëve zyrtare, zbatimi i vazhdueshëm i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimi i kapaciteteve përkthyese të institucioneve etj. AZGJ-ja në punën e saj ishte e vendosur në qëllimin aktiv, që të veprojë në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet promovimit të të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër të gjitha përpjekjeve, raportet tona nga terreni, parashtresat e qytetarëve, raportet e medieve dhe të organizatave joqeveritare, tregojnë se shumë qytetarë akoma përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj në komunikimin e përditshëm me institucionet. Kjo tregon se ka nevojë që të gjitha institucionet të japin shumë mund për t'i arritur qëllimet e caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Të udhëhequr nga qëllimi për t'u zgjidhur problemet institucionale lidhur me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në institucione dhe cilësinë e dobët të përkthimeve dhe lekturimeve nëpër dokumentet zyrtare, AZGJ-ja ndërmori një aktivitet për të realizuar trajnime për përkthim dhe lekturë nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive profesionale dhe të njësimit të procesit të përkthimit dhe të lekturës të gjuhëve zyrtare për të punësuarit, gjegjësisht personat e angazhuar që kryejnë përkthim dhe lekturim të gjuhëve zyrtare në institucionet e sektorit publik.

[1] Forma e shkurtër e emrit zyrtar: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

1.2. Historia e AZGJ-së

Më 6 shkurt 2019 u shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të AZGJ-së, që zgjati në pajtim me datën 13 shkurt 2019, ku me aktvendimin e zgjedhjes, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen mbajtur më 25 shkurt 2019, u zgjodh prof. dr. Ylber Sela si drejtor i AZGJ-së.

Më 11 mars 2019 u dorëzua fletëparaqitje për regjistrimin e themelimit të AZGJ-së në Regjistrin Qendror, ku aktvendimi për regjistrimin e themelimit u miratua më 13 mars 2019. Data formale e themelimit të AZGJ-së është 14 janar 2019, respektivisht dita e hyrjes në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e RM nr.7/2019). Nga themelimi i saj, selia formale e AZGJ-së ishte në bul. "Ilindeni" nr.2/ ndërtesa 6 – zyra 410.

Në mbledhjen e 162-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 5 nëntor 2019, Qeveria e miratoi Vendimin nr. 45-8714/1, për dhënie në shfrytëzim të përhershëm të sendeve të patundshme të AZGJ-së (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 236/2019), që ishte bazë për t'u kryer regjistrimi për ndryshimin e selisë së AZGJ-së, ku me aktvendim të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120190016864, datë 21.11.2019, u bë ndryshim i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresë të re: shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati 4, Qendër, Shkup, gjithashtu është regjistruar edhe shkurtesa e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është bërë "Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së".

Në seancën e 45-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 16 shkurt 2021, Qeveria miratoi Vendimin nr. 40-2389/1 për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të gjësendeve të patundshme AZGJ-së (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 43/2021), i cili ishte bazë për regjistrimin e ndryshimit të selisë së AZGJ-së, ndërkaq me aktvendimin e Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120210008095, datë 3.3.2021, është bërë ndryshimi i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresën e re: rr. "Filipi i Dytë i Maqedonisë" nr. 11, kati i 3-të, Shkup.

1.3. Misioni dhe vizioni

AZGJ-ja ka mision të krijojë mjedis institucional që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, që e promovon, që e ruan dhe që e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo përfshin aktivitete lidhur me ndihmesën praktike dhe përkrahjen këshillëdhënëse në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, agjencive, drejtorive, institucioneve dhe organizatave, komisioneve, personave juridikë që kryejnë autorizime publike, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale; kujdes i vazhdueshëm për zbatim të rregullt dhe të qëndrueshëm të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe), si dhe avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës, si e drejtë themelore e qytetarëve.

Vizioni i AZGJ-së është të mundësojë barazi gjuhësore të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të rregullores ligjore për përdorimin e gjuhëve. Duke nxitur cilësi të lartë të proceseve të punës, efektivitet të vazhdueshëm dhe efikasitet në punë, të plotësuar me kuadër profesional dhe kapacitete teknike, si dhe të hapur plotësisht për bashkëpunim me publikun, me sektorin akademik dhe me atë qytetar, AZGJ-ja synon të bëhet e njohur si institucion me rëndësi strategjike në procesin e mbrojtjes, avancimit, standardizimit dhe përdorimin e njësuar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA 2

2.1. Statusi

AZGJ-ja ka cilësinë e personit juridik me të drejta, me detyrime dhe me përgjegjësi të përcaktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Më 14.1.2019 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 7/2019 u shpall dhe hyri në fuqi Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, me çka AZGJ-ja u themelua në cilësinë e personit juridik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të caktuara me të njëjtin ligj.

2.2. Udhëheqja

AZGJ-në e udhëheq drejtori i zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar, me të drejtë për t'u rizgjedhur. Për punën e tij dhe për atë të AZGJ-së, drejtori i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.3. Kompetencat ligjore të AZGJ-së

Në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, AZGJ-ja është kompetente për kryerjen e punëve në vijim:

– mbështetjen e institucioneve për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
– lekturimin e të gjithë akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– përgatitjen e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zbatimin e kompetencave të saj;
– përgatitjen e materialeve profesionale-analitike nga kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe
– punë të tjera që lidhen me zbatimin e qëllimeve të vërtetuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Krahas kompetencave të saj ligjore, AZGJ-ja kujdeset për sigurimin e vazhdueshëm të funksionalitetit dhe forcimin e kapaciteteve të veta, si dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, e promovon, e ruan dhe e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.4. Parimet dhe vlerat e punës

– ligjshmëria;
– profesionalizmi dhe kompetenca;
– përfaqësimi i duhur dhe i drejtë;
– shërbimet e orientuara;
– etika profesionale, paanshmëria dhe objektiviteti;
– transparenca dhe besueshmëria;
– përgjegjësia;
– parandalimi i konflikteve të interesit;
– të qenit ekonomik; dhe
– respektimi i standardeve për udhëheqje me cilësi.

PJESA 3

3.1. Vendosja organizative

Duke u nisur nga kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Nëpunësve Administrativë, si dhe nga Dekreti për Parimet e Organizimit të Brendshëm të Organeve të Administratës Shtetërore, e me qëllim të bashkimit të disa funksioneve të ndërlidhura ndërmjet tyre, organizimin, ndjekjen dhe koordinimin me burimet njerëzore, punën profesionalo-analitike, administrative, informativo-komunikuese, operative, materiale, financiare, informatiko-teknologjike, profesionalo-administrative dhe punë të tjera, në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, AZGJ-ja është e organizuar në 4 (katër) sektorë me 9 (nëntë) njësi në përbërje të tyre dhe 2 (dy) njësi të pavarura, siç vijon:

(1) Sektori i mbështetjes së drejtorit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Njësia e mbështetjes së drejtorit; dhe
- Njësia e marrëdhënieve me publikun.

(2) Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e avancimit të zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve;
- Njësia e teknologjisë informatike; dhe

(3) Sektori i përkthimit dhe i lekturës, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e përkthimit; dhe
- Njësia e lekturës.

(4) Sektori i çështjeve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e çështjeve të përgjithshme dhe juridike; dhe
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësitë e pavarura janë:

– Njësia e çështjeve financiare; dhe
– Njësia e revizionit të brendshëm.

ORGANIGRAMI I AZGJ-së



3.2. Burimet njerëzore

Në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, janë paraparë 78 vende të punës. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të parapara të punës, 75 vende pune janë me statusin e nëpunësit administrativ, kurse tri vende janë me statusin e personave ndihmës-teknikë.

Në AZGJ me gjendjen e datës 31.12.2022 janë punësuar gjithsej 35 persona, që kanë statusin e nëpunësve administrativë, prej të cilëve 1 (një) personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës për shkak të emërimit në funksion tjetër publik. Gjatë vitit 2022, AZGJ-ja nuk ka bërë shpallje publike për punësimin e nëpunësve administrativë, por janë realizuar lëvizje të tjera të kuadrit brenda AZGJ-së, deri më 31.12.2022, nga të cilat:

1. Avancimet e realizuara:
   – 4 avancime (me shpallje të brendshme)

2. Realizimi i rritjes së kuadrit :
   – 0 punësime të reja
   – 3 persona nëpërmjet procedurës së marrjes (transferim) nga institucionet e tjera

3. Realizimi i zvogëlimit të kuadrit:
   – 3 persona nëpërmjet procedurës së marrjes (transferimit) nga institucionet e tjera
   – 1 person nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së punës me marrëveshje

Me gjendjen e 31.12.2022, përqindja e plotësimit të vendeve të punës me realizues është 45% nga numri i përgjithshëm i realizuesve të sistematizuar.

Plotësimi i vendeve të punës në AZGJ, i shprehur me numrin e realizuesve sipas njësive organizative më gjendjen e 31.12.2022 është siç vijon:

- Këshilltarë shtetërorë – 2
- Sektori i mbështetjes së drejtorit – 8
- Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit – 3

– Sektori i përkthimit dhe i lekturës – 13
– Sektori i çështjeve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore – 6
– Njësia e çështjeve financiare – 3
– Njësia e revizionit të brendshëm – 0

Në Njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në bazë të Programit vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve administrativë, të miratuar nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, po përgatitet Plani vjetor për trajnime të nëpunësve administrative, sipas mendimit të marrë nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës.

Tabela 1. Pasqyra e vendeve të punës të sistemuara dhe të plotësuara në AZGJ

Njësitë organizative	Vendet e sistemuara të punës Gjendja më 31.12.2022	Numri i plotësuar i realizuesve Gjendja më 31.12.2022
Këshilltarë shtetërorë	4	2
Sektori i mbështetjes së drejtorit	15	8 (1 personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës)
Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit	11	3
Sektori i përkthimit dhe i lekturës	25	13
Sektori i çështjeve juridike, të përgjithshme dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore	15	6
Njësia e çështjeve financiare	6	3
Njësia e revizionit të brendshëm	2	0

3.3. Struktura e të punësuarve


Plotësimi sipas kategorive të vendeve të punës të nëpunësve administrativë:

– nëpunës udhëheqës administrativë – 12
– nëpunës profesional administrativë – 23
– nëpunës ndihmës-profesionalë administrativë – 0
– persona ndihmës-teknikë – 0

Plotësimi sipas shkallës së arsimit:

– me arsim të lartë - 35
– me shkollë të mesme – 0
– me shkollë fillore – 0

Grafiku 1. Numri i të punësuarve sipas shkallës së arsimit



Plotësimi sipas strukturës gjinore:

– gjinia femërore – 21
– gjinia mashkullore – 14

Grafiku 2. Struktura gjinore e të punësuarve





Tabela 2. Struktura e të punësuarve në AZGJ me gjendjen 31.12.2022

Kategoritë e vendeve të punës	Gjinia		Shkalla e arsimit		
	M	F	PLP ose arsim i shkallës më të lartë	PMP	Fillore
Udhëheqëse	7	5	12	0	0
Profesionale	7	16	23	0	0

Ndihmëse-profesionale	0	0	0	0	0
Ndihmëse-teknike	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	14	21	35	0	0

Grafiku 3. Struktura e të punësuarve në AZGJ me gjendjen 31.12.2022



PJESA 4

4.1. Pasqyra e punës

AZGJ gjithmonë synon të sigurojë kryerjen e sigurt dhe efektive të detyrimeve ligjore që janë kyç, por edhe të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme përforcimin e kapaciteteve të veta.

Prioritetet kryesore dhe qëllimet zhvillimore të AZGJ-së rrjedhin nga kompetencat e saj ligjore dhe fokusohen në zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të rregullores ligjore për zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, por edhe në rindërtimin dhe përforcimin e saj në aspektin e kapaciteteve për kryerjen e funksioneve të saj. Në këtë kontekst, AZGJ-ja para vetes ka vendosur shumë qëllime strategjike afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të realizohen, siç vijon:

- përcjellje e vazhdueshme e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
- analizë të përvojave më të mira botërore dhe modeleve të shumëgjuhësisë;
- promovim dhe zhvillim të sistemit për zbatim aktiv të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- avancim të funksionimit dhe realizimit të kompetencave të AZGJ-së nëpërmjet sigurimit të përkrahjes administrative, logjistike dhe teknike;
- përforcim të kapaciteteve me burime njerëzore nëpërmjet punësimeve të reja, shpërndarjeve dhe avancimeve, në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe me zbatimin e parimeve të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, si dhe nëpërmjet përsosjes profesionale të të punësuarve në AZGJ;
- përforcim të punës financiare dhe materiale, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit strategjik në AZGJ, e plotësuar me aktivitete për themelimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e udhëheqjes financiare dhe kontrollit;
- përmirësim të punës së AZGJ-së, nëpërmjet rritjes së efektshmërisë së sistemeve për kontroll të brendshëm dhe pajtim të punës me ligjet, me aktet nënligjore dhe me aktet e brendshme;
- themelim të programeve për të punësuarit në AZGJ për zhvillim sistemor të shkathtësive të tyre, njohurive dhe sjelljes, të nevojshme këto për realizimin e qëllimeve afatmesme dhe afatgjata;

- themelim dhe avancim të bashkëpunimit me palët përkatëse të interesuara, duke përfshirë edhe organet shtetërore, dhomat ekonomike, sektorin joqeveritar, bashkësinë e donatorëve, korin diplomatik, organizatat ndërkombëtare.

4.2. Përkthimi dhe lekturimi

Gjatë vitit 2022 në AZGJ janë dorëzuar 105 kërkesa për përkthim me lekturim dhe 334 kërkesa për lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare.

Tabela 3. Pasqyra e kërkesave për përkthim dhe për lekturim

Përkthim me lekturim	% e përkthimeve të realizuara	Vetëm lekturim	% e kërkesave të realizuara për lekturim
105	100%	334	100%


4.3. Pyetësorët anketues

AZGJ-ja gjatë vitit 2022 dorëzoi pyetësorë anketues, me një paketë pyetjesh të strukturuara tek 358 institucionet e sektorit publik, ku është e nevojshme të bëhet zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.


Pyetësorit anketues i janë përgjigjur gjithsej 108 institucione, gjegjësisht 30,17% nga institucionet e anketuara.

Në vijim është dhënë një pasqyrë në formë grafiku të rezultateve të fituara në raport me çdo pyetje nga pyetësori anketues.


1. A i keni përmbushur detyrimet në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve dhe në qoftë se nuk i keni përmbushur në tërësi, në cilën fazë të zbatimit keni arritur?



2. Në aktin tuaj të sistematizimit të vendeve të punës, a keni paraparë formë organizative për përkthim dhe lekturë në dhe prej gjuhës shqipe?




3. Sa përkthyes dhe sa lektorë keni të punësuar në institucionin tuaj?




4. Vallë, në buxhetin e e vitit 2023, a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe për lektorë të rinj?



5. A keni nevojë për ndihmë profesionale nga Agjencia?




6. Deri tani, a keni kërkuar ndihmë profesionale nga Agjencia?



7. A jeni të kënaqur nga ndihma profesionale e Agjencisë?



8. A keni kërkuar pëlqim për të transferuar përkthyes nga Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive



4.4. Regjistri (baza e të dhënave)

AZGJ-ja përgatiti regjistër të personave me status të nëpunësve administrativë, persona të angazhuar në bazë tjetër apo bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilëve u janë dhënë detyra pune për përkthim dhe lekturim, nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas. Ky regjistër do t'i shërbejë AZGJ-së, që të krijojë një pasqyrë të plotë të gjendjes me kuadrin e përkthyesve dhe të lektorëve në organet e pushtetit qendror, me qëllim që në të ardhmen edhe ata të mund të përfshihen nëpër programet dhe trajnimet për përkthyes dhe lektorë, që i organizon AZGJ-ja.

4.5. Trajnimi për përkthyesit dhe për lektorët e sektorit publik

Gjatë vitit 2022, AZGJ-ja ka realizuar trajnim për 72 përkthyes dhe lektorë nga 43 institucione shtetërore, të ndarë në 6 grupe, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e kapaciteteve profesionale për përkthim dhe lekturim, si dhe njësimin terminologjisë administrative, në bashkëpunim me gjuhëtarë dhe ekspertë të njohur të gjuhës. Trajnimi filloi më 14 mars dhe zgjati deri më 27 maj, ku morën pjesë ligjërues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës.



Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësi të trajtojnë një sërë çështjesh që shfaqen nga përdorimi i gjuhës shqipe në administratën publike. Problemi i terminologjisë dhe njësimi i saj si nevojë, ndikimet e gjuhëve, leksikografia, semantika, ndikimet sintaksore e një sërë problemesh të tjera, ishin objekt shtjellimi nga profesorët Emil Lafe, Valter Memisha, Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Dorian Koçi, Manjola Lumani, Olger Brame, Artur Lama, Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Zeqirija Ibrahimi, Berton Sulejmani, Bashkim Selmani, Adnan Jashari, Afet Mamuti, Mustafa Ibrahimi, Ajten Hajdari-Qamili, Arta Selmani, Arsim Jonuzi dhe Ali Pajaziti.

Me mbështetjen financiare dhe teknike të Misionit të OSBE-së në Shkup, në vitin 2021 është përgatitur edhe Manuali për trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve, në 3 (tri) gjuhë, si dhe ky i është shpërndarë secilit pjesëmarrës në trajnim.



Më 2 shtator 2022, AZGJ-ja organizoi një ceremoni përmbyllëse në të cilën u dorëzuan certifikatat për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim. Më shumë informacione në lidhje me trajnimin mund të lexoni në pjesën 6 të raportit.

4.6. Trajnimet për të punësuarit në AZGJ

AZGJ-ja gjithmonë përpiqet dhe do të vazhdojë t'i përmirësojë dhe t'i perfeksionojë aftësitë dhe kapacitetet profesionale të të punësuarve të saj, dhe në këtë kuadër, në vitin 2022 krahas kufizimeve për shkak të restriksioneve buxhetore të shkaktuara nga kriza ekonomike dhe energjetike, realizoi trajnime për forcimin e kompetencave dhe aftësive të punës të të punësuarve të saj për t'i arritur objektivat e punës për efikasitet në mënyrë ekonomike dhe efektive.

Në sallën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë muajit qershor është mbajtur trajnimi për përkthim simultan, 7 (shtatë) ditë radhazi, në të cilin kanë marrë pjesë gjithsej 12 (dymbëdhjetë) persona nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së.

Realizimi i trajnimit u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup në pajtim me Planin vjetor të veprimit që rezulton nga nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për periudhën 2021- 2024.

Krahas financimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e trajnimit, Misioni i OSBE-së në Shkup siguron edhe ekspertizë të nevojshme me angazhimin e dy trajnuesve të certifikuar dhe interpretues të akredituar në BE (dr. Blerina Starova Zllatku dhe dr. Lukrecija Malkoviq Atanasovska) dhe në bashkëpunim me AZGJ-në i ka koordinuar aktivitetet e nevojshme në lidhje me mbajtjen e trajnimit me sukses.

Trajnimi përfshinte një sërë ligjërimesh dhe ushtrimesh praktike me qëllim të përmirësimit të aftësive dhe teknikave për interpretim simultan të stafit profesional që disponon AZGJ-ja.


OSCE Organization for Security and Co-operation in Europe Mission to Skopje
Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ
Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
Trajnim për interpretim simultan
Обука за симултано толкување
Training for simultaneous interpretation




Агенција за примена на јазикот на РСМ
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
Language Implementation Agency of RNM

Trajnimi për shfrytëzimin e bazës elektronike të rregullave të Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Më 9 nëntor 2022, përfaqësues të NP Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë mbajtur trajnim në hapësirat e AZGJ-së për mënyrën e shfrytëzimit të bazës elektronike të rregullave të cilat janë në dispozicion të ndërmarrjes publike.

Baza elektronike e rregullave është mjet i dobishëm që do ta lehtësojë punën e përditshme operative të AZGJ-së, me qasje të mundshme deri te arkivi i pasur me akte legjislative, të organizuara në fusha dhe nënfusha, me opsione për kërkim të shpejtë të tyre dhe mundësi për qasje deri te redaksia e rregullave me tekste të konsoliduara.





4.7. Parashtresat

Në vitin 2022, në AZGJ u dorëzuar 5 (pesë) parashtresa, ku në bazë të përmbajtjes së tyre, u vërtetua nëse ajo është në kompetencë të AZGJ-së. Parashtruesi merr përgjigje profesionale në kohë, e nëse parashtresa nuk është në kompetencë të AZGJ-së, ajo përcillet tek organi kompetent, ku informohet edhe dorëzuesi i parashtresës se te cili organ është dërguar për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për të vepruar sipas saj.

Parashtresat kanë të bëjnë me çështje që lidhen me kufizimet në aspektin e zbatimit të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe) në fusha të veçanta.

4.8. Informimi

AZGJ-ja në mënyrë të vazhdueshme ka punuar për ngritjen e vetëdijes së popullatës dhe të institucioneve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjuhësore. Komunikimi u realizua në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët, me sektorin joqeveritar dhe me përfaqësuesit e institucioneve, nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit (në mënyrë elektronike, nëpërmjet ueb-faqes së AZGJ-së, takime pune, takime në terren e të tjera).

4.9. Buletini mujor

AZGJ-ja në nivel mujor përgatit buletinin për aktivitetet, me qëllim që të përmirësohet transparenca në punë.

Buletini shpallet në ueb-faqen zyrtare të AZGJ-së, në gjuhën maqedonase, atë shqipe dhe në atë angleze, dhe përmban një pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve mujore që janë realizuar.




4.10. Ueb-faqja zyrtare dhe mediet digjitale

Ueb-faqja zyrtare e AZGJ-së - www.apj.gov.mk dhe www.azgj.gov.mk, vazhdimisht përditësohet me përmbajtje informative në 3 (tri) gjuhë, lidhur me aktivitetet e AZGJ-së, me qëllim që të ruhet parimi i transparencës dhe mundësisë së AZGJ-së për qasje te publiku më i gjerë.

AZGJ-ja shpërndan aktivitetet lidhur me punën e saj edhe në rrjetet sociale Facebook dhe në YouTube.





4.11. Fjalori elektronik VERBIS

Në kuadër të AZGJ-së funksionon fjalori kontekstual interpretues elektronik VERBIS në formën e një fjalori përshkrues dygjuhësh, maqedonisht dhe shqip. Ai shpjegon në pikëpamje leksikore fondet e fjalëve më të përdorura në të dyja gjuhët.

Fjalori përmban module nga fusha administrativo-juridike, ekonomiko-financiare, shëndetësore dhe terminologjisë së përgjithshme.

Moduli i fushës administrativo-juridike përmban 10.000 fjalë, kurse janë përgatitur edhe fonde fjalësh për modulet e fushës së shëndetësisë dhe asaj me terminologji ekonomike-financiare.

Fjalori gjendet në www.verbis.gov.mk.



4.12. Botimet e shtypura dhe ato elektronike



4.13. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, përveç memorandumeve të bashkëpunimit të lidhura në vitin 2019, 2020, dhe në vitin 2021 e bën formale bashkëpunimin me subjektet e reja institucionale nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, duke nënshkruar edhe 4 (katër) memorandume bashkëpunimi në vitin 2022.

Në vazhdim jepet renditja kronologjike e memorandumeve të bashkëpunimit, të nënshkruara në vitin 2022.

22 shkurt 2022 – Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Muzeut Historik Kombëtar - Tiranë



23 shkurt 2022 – Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Universitetit "Fan Noli" – Korçë



10 maj 2022 – Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Universitetit „Aleksandër Xhuvani" – Elbasan



26 maj 2022 – Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Kolegjit Universitar WISDOM – Tiranë



4.14. Pasqyra e akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në pajtim me nenin 17, paragrafi (1) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.7/2019), të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, që shpallen në Gazetën Zyrtare të RMV-së, shpallen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

AZGJ-ja përgatiti pasqyrë statistikore të të gjitha akteve të shpallura në vitin 2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që përbëhet nga institucionet sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në bazë të pasqyrës së përgatitur, është vërtetuar përqindja e pajtimit të institucioneve në aspektin e zbatimit të detyrimit sipas nenit 17 të ligjit.

Tabela 4. Pasqyrë e akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të RMV-së në vitin 2022

Numri rendor.	EMRI I INSTITUCIONIT	Botimet e përgjithshme të publikuara	Botimet e publikuara vetëm në gjuhën maqedonase	Botimet e publikuara në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve	Përqindja e harmonizimit të detyrimit nga neni 17 i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (%)
1	QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	212	211	1	0,47%
2	PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	38	38	0	0%
3	KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	58	1	57	98,28%
4	MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE	23	11	12	52,17%
5	MINISTRIA E FINANCAVE	8	4	4	50%
6	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	15	14	1	6,67%
7	MINISTRIA E DREJTËSISË	40	40	0	0%

8	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMIZIMIT TË UJËRAVE	13	13	0	0%
9	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	8	0	8	100%
10	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	4	4	0	0%
11	MINISTRIA E EKONOMISË	19	8	11	57,89%
12	MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS	2	0	2	100%
13	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	7	6	1	14,29%
14	MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE	9	9	0	0%
15	MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	8	5	3	37,5%
16	MINISTRIA E KULTURËS	2	2	0	0%
17	MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE	2	2	0	0%
18	BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	19	1	18	94,74
19	AGJENCIA E KADASTRËS SË PATUNDSHMËRIVE	12	12	0	0%
20	AGJENCI E USHQIMIT DHE VETERINARISË	26	26	0	0%
21	KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT	1	0	1	100%
22	AGJENCIA PËR MBIKËQYRJEN E SIGURIMIT PENSIONAL TË FINANCUAR NGA KAPITALI (MAPAS)	5	1	4	80%
23	AGJENCIA E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	7	6	1	14,29%
24	AGJENCI PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE	7	0	7	100%
25	AGJENCIA E TË RINJVE DHE SPORTIT	4	4	0	0%
26	AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	3	0	3	100%
27	AGJENCI POSTARE	1	1	0	0%
28	AGJENCI PËR BARNA DHE PAJISJE MJEKËSORE (MALMED)	1	1	0	0%

29	KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË	42	1	41	97,62%
30	KOMISIONI RREGULLATOR I SHËRBIMEVE TË ENERGJETIKËS DHE UJIT	175	0	175	100%
31	FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR	9	0	9	100%
32	FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	2	1	1	50%
33	KOMISIONI SHTETËROR ZGJEDHOR	1	0	1	100%
34	ENTI SHTETËROR I STATISTIKAVE	10	0	10	100%
35	GJYKATA KUSHTETUESE	9	9	0	0%
36	GJYKATA E LARTË	2	1	1	50%
37	NP E UJËSJELLËSIT "STUDENÇICA" - KËRÇOVË	2	2	0	0%
38	KËSHILLI I PROKURORËVE PUBLIKË	14	14	0	0%
39	KËSHILLI GJYQËSOR	22	0	22	100%
40	KOMISIONI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	4	4	0	0%
41	ODA FARMACEUTIKE	1	1	0	0%
42	GA-MA SHA SHKUP	1	1	0	0%
43	AGJENCIA E ZBULIMIT	1	1	0	0%
44	AKADEMIA E TRAJNIMIT PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIKË	2	2	0	0%
45	ODA DENTARE	1	1	0	0%
46	PROKURORIA PUBLIKE E RMV-SË	1	1	0	0%
47	DREJTORIA E FARËRAVE DHE MATERIALIT FIDANOR	4	4	0	0%
48	SHA MEPSO	2	2	0	0%
49	KËSHILLI INSPEKTUES	4	1	3	75%

50	NP "GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT"	2	2	0	0%
51	AVOKATI I POPULLIT	1	1	0	0%
52	AGJENCIA PËR CILËSINË DHE AKREDITIMIN E OBJEKTEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR	1	1	0	0%
53	DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	1	1	0	0%
54	AGJENCIA E SIGURISË KOMBËTARE	1	1	0	0%
55	ODA E PËRMBARUESVE	14	14	0	0%
56	KOMISIONI LEGJISLATIVO-JURIDIK I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	0	0%
57	ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT	1	0	1	100%
58	AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE	8	4	4	50%
59	KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS	1	0	1	100%
60	DREJTORIA E ZONAVE TË ZHVILLIMIT INDUSTRIALE TEKNOLOGJIKE	2	2	0	0%
61	AGJENCIA E AVIACIONIT CIVIL	1	1	0	0%
62	AGJENCIA E SIGURISË NACIONALE	1	1	0	0%
63	EMV DISTRIBUCIONI I NGROHJES SHPKNJP- SHKUP	1	1	0	0%
64	KËSHILLI PËR PROMOVIMIN DHE MBIKËQYRJEN E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT TË RMV-SË	1	1	0	0%

PJESA 5

5.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi

AZGJ-ja si organ shtetëror i pavarur është shfrytëzues i buxhetit.

Në vitin 2022, buxheti i përgjithshëm bazë i AZGj-së, i miratuar, ishte 49.0454.000,00 denarë. Me ribalancën e buxhetit për vitin 2022, buxheti i përgjithshëm i AZGj-së është reduktuar në vlerë të përgjithshme prej 47.303.000,00 denarë.


Tabela 5. Struktura e buxhetit të AZGJ-së për vitin 2022

Zëri	Përshkrimi	BUXHETI PËR VITIN 2022 (në kundërvlerë denari)					RIBALANCA E BUXHETIT PËR VITIN 2022	
		Buxheti (630)	Shpenzime nga të ardhurat prej organeve (631)	Shpenzimet nga aktivitete vetëfinan-cuese (787/788)	Shpenzime nga donacio-ne (785)	Gjithsej shpenzi-me	Gjithsej shpenzime	Përqindja e realizimit (%) (përfshirë të dy ribalancat e buxhetit)
40	Rroga dhe kontribute	19.800.000,00	/	/	/	19.800.000,00	18.835.000,00	95,21%
401	Rrogat bazë	14.454.000,00	/	/	/	14.454.000,00	13.489.000,00	94,34%
402	Kontribute të sigurimit social	5.346.000,00	/	/	/	5.346.000,00	5.346.000,00	91,30%
404	Kompensime	0,00	/	/	/	0,00	315.000,00	**100%**
42	Mallra dhe shërbime	19.534.000,00	/	/	/	19.534.000,00	17.959.000,00	65,07%
420	Shpenzime ditore dhe rrugore	50.000,00	/	/	/	50.000,00	80.000,00	62,29%
421	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	1.505.000,00	/	/	/	1.505.000,00	2.355.000,00	58,79%
423	Materiale dhe inventari i imët	281.000,00	/	/	/	281.000,00	200.000,00	88,18%

424	Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme	500.000,00	/	/	/	500.000,00	1.300.000,00	58,83%
425	Shërbime kontraktuese	16.000.000,00	/	/	/	16.000.000,00	13.050.000,00	65,34%
426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	1.198.000,00	/	/	/	1.198.000,00	974.000,00	56,99%
464	Transferta të ndryshme	0	/	/	/	0	160.000,00	100%
48	Shpenzime kapitale	10.120.000,00	/	/	/	10.120.000,00	4.709.000,00	72,84%
480	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	2.000.000,00	/	/	/	2.000.000,00	507.769,00	72,32%
481	Objekte ndërtimi	120.000,00	/	/	/	120.000,00	35.700,00	0%
483	Blerja e mobilieve	0,00	/	/	/	0,00	71.000,000	98,03%
485	Investime dhe pasuri jofinanciuese	8.000.000,00	/	/	/	8.000.000,00	4.094.531,00	48,17%
486	Blerja e automjeteve	0,00	/	/	/	0,00	0,00	0%


Në grafikun që vijon paraqitet një pasqyrë kronologjike e buxhetit të AZGJ-së për periudhën e vitit 2019-2022, me ribalancat vjetore të përfshira të buxhetit.

Grafiku 4. Buxheti i AZGJ-së për periudhën e vitit 2019-2022



	2019	2020	2021	2022
Buxheti i përgjithshëm	8.425	60.00	46.078	49.454
Ribalanca e parë	38.425	34.291	42.924	47.303
Ribalanca e dytë		34.291		

Grafiku 5. Buxheti i AZGJ-së në vitin 2022



5.2. Furnizimet publike

1. Numri i vendimeve të marra për furnizime publike: 15
2. Numri i shpalljeve publike për furnizime publike në SEFP: 15
3. Numri i procedurave të filluara me bisedime pa shpallje paraprake: 0
4. Numri i vendimeve të miratuara për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme: 10
5. Numri i procedurave të anuluara: 5
6. Numri i kontratave të lidhura për furnizime publike: 12
7. Vlera e kontratave të lidhura:
   4.569.270,00 MKD (pa TVSH)
   5.142.297,00 MKD (me TVSH)

Vendime të miratuara për furnizime publike	Shpallje të publikuara në SEFP	Procedura të iniciuara me negocim pa shpallje paraprake të publikuar	Vendime të marra për zgjedhjen e ofertës më të volitshme	Vendime të miratuar për anulimin e procedurave	Kontrata të lidhura për furnizime publike	Vlera e kontratave të lidhura (pa TVSH)
15	15	0	10	5	12	4.569.270,00 MKD

PJESA 6

6.1. Pasqyra e aktiviteteve të realizuara

AZGJ-ja në vitin 2021 realizoi bashkëpunim me një numër të madh institucionesh dhe organizatash nëpërmjet takimeve të punës, ngjarjeve, konferencave, seminareve, trajnimeve, takimeve onllajn, edhe pse ka punuar në kushte të restrikcioneve dhe masave buxhetore në raport me shfrytëzimin e mjeteve për realizimin e aktiviteteve zyrtare.

Në vazhdim të raportit është shfaqur përmbledhja e ngjarjeve të realizuara, takimeve dhe aktiviteteve në vitin 2022.

20 janar 2022

Në Institutin Albanologjik të Prishtinës u promovua libri "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019"

Memorandumi i bashkëpunimit, i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, po bëhet gjithnjë e më i frytshëm. Këtë e dëshmon edhe promovimi i librit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019" të autorëve Ylber Sela, Jeton Shasivari, Argëtim Saliu, Jusuf Zejneli, Valbona Hajredini dhe Llazo Matovski, botim ky i AZGJ-së që doli kohë më parë.



Ky aktivitet u mbajt në Institutin Albanologjik të Prishtinës ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm punonjësish shkencorë, profesorësh universitarë, intelektualësh të shumtë, përfaqësues të medieve, studentë etj.

Në fillim të pranishmit i përshëndetën Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, dhe Arsim Sinani, drejtor i Institutit të Studimeve Sociale e Humanistike të Universitetit të Prishtinës.

Pastaj drejtori Ylber Sela foli për Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, duke dhënë një pasqyrë përmbledhëse për këtë institucion që nga themelimi i tij e deri më sot.

Ndërkaq, për përmbajtjen, rëndësinë dhe vlerat shkencore të librit në fjalë folën Jusuf Zejneli, profesor në Universitetit e Tetovës, Jeton Shasivari, profesor në Universitetin e Europës Juglindore, dhe Naim Berisha, shef i Degës së Gjuhësisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës.







20 janar 2022

Fjala e udhëheqësit të degës së Gjuhësisë pranë Institutit Albanologjik në Prishtinë, Prof. asoc. dr. Naim Berishës, rreth librit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019"

Të nderuar të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj!

Ndjehem i nderuar që më është dhënë rasti t'i them disa fjalë për një botim të rëndësishëm dhe të veçantë, me autorë Ylber Selën, Jusuf Zejnelin, Jeton Shasivarin, Argëtim Saliun, Valbona Hajretinin dhe Llazo Matovskin.

Është i rëndësishëm sepse tematikat janë me mjaft peshë, aktuale dhe të trajtuara me kompetencë. Ndërsa është i veçantë, sepse ka për autorë emra të dëshmuar e të respektuar të disa fushave, ndërkaq është botuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në RMV-së, institucion ky i cili gjatë viteve të funksionimit është bërë sinonim i punës, seriozitetit dhe sukseseve të mëdha.



Pas kumtesave që i lexuan profesorët, Jusuf Zejneli dhe Jeton Shasivari, të cilët janë edhe autorë të këtij libri, do të mundohem të mos i përsëris ato që u thanë.

Që nga nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Institutit Albanologjik dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës para pak kohësh, aktiviteti i sotëm është i treti me radhë që institucionet tona janë duke bashkëpunuar. Sot, jemi mbledhur për ta promovuar një botim të një natyre të veçantë, që lidhet me shumë tematika të rëndësishme, në mënyrë të posaçme me veprimtarinë e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ashtu siç është theksuar në parathënie, në këtë libër është trajtuar niveli i zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019. Ky studim përfshin punën kërkimore, rishikimin e akteve ligjore që rregullojnë çështjet në këtë fushë e cila përfshin qeverisjen qendrore dhe atë lokale. Lënda e trajtuar ofron

një analizë të hollësishme të gjendjes, të nevojës, të cilësisë dhe të përgjegjësisë së rregullave ligjore si pjesë thelbësore e këtij procesi të mundimshëm dhe të gjatë.

Materiali që na prezantohet në këtë libër gjithashtu është një histori e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, që nga themelimi i Maqedonisë si shtet e deri më sot kur gjuha shqipe gëzon një status më të përparuar, të rregulluar me ligj të veçantë. Ky rrugëtim ishte një proces i mundimshëm dhe me plot vështirësi, që në mënyrë të vazhdueshme kërkonte sakrificë njerëzore dhe intelektuale, për të ardhur në vitin 2019 kur u miratua Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, i konsideruar si një sukses, me të cilin gjuha shqipe arriti nivelin më të lartë të përdorimit zyrtar.

Autorët e këtij libri, të cilët vijnë nga institucione të ndryshme dhe janë profesionistë të disa profileve që lidhen kryesisht me fushën e drejtësisë, në mënyrë kronologjike dhe përmbledhëse i kanë trajtuar aspektet juridike të pozicionit të shqipes që nga fillesa e funksionimit të Maqedonisë si shtet e këtej. Kur e kemi parasysh këtë hark kohor, bie në sy trajtimi i pozicionit diskriminues që e kishte shqipja për një periudhë të gjatë, pastaj kthesa e madhe që ndodhi në vitin 2001 me Marrëveshjen e Ohrit e deri te miratimi i Ligjit më 2019.

Ky libër, përveç pjesëve hyrëse, është i ndarë në 3 krerë tematikë në të cilët paraqiten dhe trajtohen dokumentet të cilat e rregullojnë statusin e shqipes në Maqedoninë e veriut dhe barazinë gjuhësore, pra është një kontribut më vlera që ndihmon në kultivimin e dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Materialet dhe rezultatet e këtij studimi ndërdisiplinar janë ndihmesë e rëndësishme edhe për studimet gjuhësore të fushës së sociolinguistikës, sidomos për ato që trajtojnë tematika që lidhen me statusin e gjuhëve dhe planifikimin gjuhësor.

Vlerë e shtuar e këtij libri është edhe botimi i tij në 3 gjuhë, shqip, anglisht dhe maqedonisht, duke ua mundësuar në radhë të parë studiuesve, që ta kuptojnë tematikën dhe ta kenë më të lehtë qasjen në studime që lidhen me këtë fushë, por edhe lexuesve të zakonshëm, që t'i kuptojnë të drejtat e tyre gjuhësore të garantuara me ligj.

Pa dashur të hyjmë në detaje të veçanta të krerëve të këtij libri, mund të shprehemi se përmes tij përmbledhtas prezantohet gjendja e shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut para dhe pas Marrëveshjes së Ohrit, përpjekjet e mëdha të shqiptarëve për të ardhur deri te miratimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve si e drejtë legjitime dhe e munguar, por edhe angazhimi dhe puna e madhe që është duke u bërë për zbatimin e këtij ligji në vitet e fundit.

Përdorimi zyrtar e ligjor i shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas këtij ligji, e bëri të mundur edhe themelimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhës, si dy institucione të cilat kujdesen për të ndihmuar dhe për ta zbatuar përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet shtetërore. Kur kemi parasysh specifikat e funksionimit të

Maqedonisë së Veriut si shtet, mendojmë se të dyja këto institucione kanë dhe do të kenë sfida në punën e tyre.

Për fund, konsideroj se botimi i këtij libri është një prurje mjaft e rëndësishme e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, që do të ndihmojë në thellimin dhe avancimin e studimeve dhe të përdorimit praktik të shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ju faleminderit!

21 janar 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela – vizitë në Komunën e Bogovinës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, si Nebi Bilalli, Këshilltar Shtetëror i Përkthimit, Shpresa Zeqiri Ibrahimi, udhëheqëse e Njësisë së mbështetjes së drejtorit dhe Nerxhivane Kuqi, bashkëpunëtore për marrëdhënie me publikun, sot e vizituan Komunën e Bogovinës, ku u pritën nga kryetari i kësaj komune, z. Besnik Emshiu me bashkëpunëtorët e tij, si Minur Asani, përgjegjës për arsim dhe Blerim Isaku, inspektor komunal i arsimit.



Gjatë këtij takimi të pranishëm ishin edhe arsimtarët e Gjuhës shqipe të kësaj komune, ku në diskutim mjaft të frytshëm dolën në pah probleme të natyrës së teksteve shkollore të kësaj lënde mësimore, mungesës së lektyrave shkollore si edhe përdorimit të standardit të gjuhës shqipe.

AZGJ-ja nga ana e saj u zotua që nëpërmjet projekteve të ndryshme, pas vizitës që do t'ju bëjë të gjitha komunave ku mësohet gjuha shqipe, të dalë me strategji dhe projekte konkrete.

31 janar 2022

Drejtori i AZGj-së, Sela takoi drejtorin e Agjencisë së Investimeve të Huaja, Bekim Emini

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela dhe një pjesë e kabinetit të tij kanë takuar drejtorin e Agjencisë së Investimeve të Huaja, Bekim Emini dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në këtë takim u diskutua për shkallën e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës Shqipe në këtë institucion dhe mënyrat më efikase të zbatimit të tij.



Me këtë rast, drejtori Emini kërkoi sqarime shtesë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për zbatimin e ligjit në Agjencinë e Investimeve të Huaja, ndërkaq drejtori Sela ofroi mbështetje të plotë të AZGj-së në përkthimin e akteve, të shkresave dhe të formularëve me kapacitetet që zotëron.

Të dy bashkëbiseduesit u dakorduan që ky takim të jetë nismë e mbarë drejt hapave konkretë në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion.

8 shkurt 2022

Qendra e Bashkëpunimit Ballkanik – LOJA dhuron botime për AZGJ-në

Qendra e Bashkëpunimit Ballkanik – LOJA, Tetovë (CBC LOJA), dhuron një sërë botimesh që do ta pasurojnë fondin e bibliotekës së AZGJ-së.



Një nga publikimet që u botua është "Përmbledhja e Punimeve për Arsimin dhe Diversitetin Kulturor", i prezantuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të Arsimit Multikulturor, organizuar nga Qendra e Bashkëpunimit Ballkanik – LOJA, Tetovë, (CBC LOJA), në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut), e mbështetur edhe nga Qendra Gjermane për Trajnim dhe Rrjetëzim "KURVE" Wustrow.



Përmbledhja e punimeve përmban edhe punim autorial të përfaqësuesit të AZGJ-së, mr. Llazo Matovski, me temën "Koncepti i multikulturalizmit në kohë krize" ("The Concept of Multiculturalism in Times of Crisis").

Me këtë rast, AZGJ-ja e falënderon Qendrën e Bashkëpunimit Ballkanik – LOJA, Tetovë, për botimet e dhuruara dhe mbetet gjithmonë e hapur për bashkëpunim me përfaqësuesit e sektorit joqeveritar.

8 shkurt 2022

AZGJ-ja dhe NP Radiodifuzioni Nacional u dakorduan për bashkëpunim

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, ishte nikoqir i ushtruesit të detyrës së drejtorit të Ndërmarrjes Publike të Radiodifuzionit Nacional – Shkup, z. Endrin Kadriu.

Në këtë takim u diskutua për disa aspekte në lidhje me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e ndërmarrjes publike, e cila ushtron veprimtari me interes publik në fushën e komunikimeve elektronike.



Drejtori Kadriu u falënderua për mundësinë e takimit dhe për ndihmën rreth sqarimit të disa çështjeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Nga ana tjetër, drejtori Sela ofroi ndihmën e plotë për sa i përket e këmbimit të mendimeve, konsultimeve profesionale, si dhe rreth përkthimit dhe lekturimit të akteve dhe formularëve të përgjithshëm të kësaj ndërmarrjeje publike, me kapacitetin e kuadrit që e ka në dispozicion AZGJ-ja.

Të dy u zotuan se takimet e këtilla kontribuojnë për avancimin e bashkëpunimit me interes të zbatimit të plotë dhe të vijueshëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

9 shkurt 2022

Vizitë pune Inspektoratit Shtetëror të Tregut

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, sot realizoi vizitë pune në Inspektoratin Shtetëror të Tregut, ku u takua me Aneta Simeska Dimoskën, ushtruese e detyrës së drejtoreshës së inspektoratit.

Qëllimi i vizitës ishte të shihet gjendja rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në funksionimin e inspektoratit. Konstatimi i të dyja palëve është se inspektorati është vonuar në zbatimin e detyrimeve nga faza e parë e zbatimit të ligjit, si ndryshimi i vulës zyrtare, vulat katrore, memorandumi i akteve zyrtare etj. Gjithashtu është e nevojshme që formularët zyrtarë që përdoren në punën e inspektoratit të përgatiten në gjuhët zyrtare në mënyrë që të jenë të harmonizuara me rregullat ligjore.



Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan se ekziston vullneti i kryesisë së re të inspektoratit për të respektuar Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve dhe se takimi i tillë është më se i dobishëm, sepse është mundësi për të shkëmbyer qëndrime për çështje të caktuara që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Drejtori Sela dorëzoi një sërë botimesh dhe ofroi mbështetje për përfshirjen e stafit të inspektoratit në programin e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve të zbatuar nga AZGJ-ja, si dhe ndihmë në përkthimin dhe lektorimin e akteve të përgjithshme dhe formularëve, me të cilët vepron inspektorati.

Të dyja palët u zotuan për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në interes të sigurimit të përmbushjes së plotë dhe të përpiktë të detyrimeve ligjore.

10 shkurt 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, vizitë në Komunën e Kumanovës

Në vazhdën e aktiviteteve që po zhvillon Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në të gjitha komunat ku jeton popullatë shqiptare, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, me bashkëpunëtorët e tij, vizituan Komunën e Kumanovës, ku u pritën nga kryetari i kësaj komune, Maksim Dimitrievski, si dhe nga drejtorët dhe arsimtarët e gjuhës shqipe të shkollave fillore dhe atyre të mesme të kësaj komune.



Gjatë këtij takimi u fol për nivelin e zbatimit të dygjuhësisë në këtë komunë dhe për probleme të tjera të kësaj natyre.

AZGJ-ja, nga ana e saj u zotua, se nëpërmjet projekteve të ndryshme, pas vizitës që do t'ju bëjë të gjitha komunave ku mësohet gjuha shqipe, do të dalë me strategji, propozime dhe aktivitete konkrete.

16 shkurt 2022

AZGJ-ja nis bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Përkthimit në Komisionin Europian

Si rezultat i përpjekjeve për lidhje ndërkombëtare me institucione dhe organizata të huaja nga fushat e shkencave gjuhësore, përkthimit, interpretimit dhe lekturimit, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, nisi bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Përkthimit në Komisionin Europian. Për këtë qëllim, sot u mbajt një takim online me përfaqësues të drejtorisë, përkatësisht me Xhosefine Hederstroemin, Klaudia de Stefanisin dhe Jovana Stojkovska- Birtanovskën.

Takimi ishte një mundësi e shkëlqyer për të prezantuar punën e AZGJ-së para përfaqësuesve të Drejtorisë, për të vendosur komunikimin dhe diskutimin fillestar për çështje me interes të përbashkët.



Drejtori Sela falënderoi për mundësinë e takimit dhe i njoftoi bashkëbiseduesit për punën e deritanishme të AZGJ-së, projektet e realizuara, publikimet e përgatitura dhe konferencat e mbajtura shkencore, seminaret dhe trajnimet, si dhe prezantoi projektet e AZGJ-së për vitin 2022, përfshirë fillimin e ciklit të dytë të trajnimeve për përkthyes dhe lektorë; shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, e cila do të mbahet në fillim të javës së ardhshme; promovimin e punimit shkencor në mars të këtij viti, që analizon aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; trajnimi i përkthimit simultan për përkthyes në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup; projekti për përditësimin e fjalorit dygjuhësh të

interpretimit kontekstual VERBIS etj. Drejtori Sela gjithashtu theksoi interesimin e AZGJ-së për të dërguar një pjesë të ekipit të saj të ekspertëve në një vizitë studimore në Bruksel apo Luksemburg, ku ndodhen zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Përkthimit të Komisionit Europian.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Përkthimit falënderuan për prezantimin shterues të punës së AZGJ-së, u zotuan për vazhdimin e komunikimit me AZGJ-në, si dhe për të shqyrtuar mundësinë e realizimit të temave që u diskutuan në këtë takim.

21 shkurt 2022

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës shënon Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare

Me rastin e 21 Shkurtit – Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, në hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV- së, u mbajt tryezë e rrumbullakët me temë "Gjuha amtare – përfitim civilizues ose barrierë demokratike në shekullin XXI".

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, e hapi tryezën me fjalën e tij para të pranishmëve, panelistëve dhe përfaqësuesve të medieve. "Gjuha është aftësi e lindur biologjike, por mësimi i saj është proces i përjetshëm. Është burim i pashtershëm që rrjedh dhe që duhet të kultivohet, të përmirësohet dhe të kujdesemi për pastërtinë e saj. Gjuha amtare jo vetëm simbolizon veçantinë e një populli, e një kulture, një historie, por shërben edhe për bashkimin e njerëzve dhe lidhjen kulturore të brezave që ndërtojnë vlera civilizuese në shoqëri", tha drejtori Sela.

Në vazhdim të fjalës së tij, drejtori Sela theksoi se në këtë datë të rëndësishme shprehim respektin tonë për gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare në nivel institucional dhe gjuhë amtare e shumë qytetarëve në vendin tonë dhe se gjuha amtare dhe përdorimi pa probleme i saj është një e drejtë themelore e çdo individi, e garantuar me akte të shumta ndërkombëtare.

Në tryezën e rrumbullakët folën edhe Lulzim Aliu, zëvendësministër i Arsimit dhe i Shkencës; Xhelal Hoxhiq, zëvendësdrejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Pakicave; Xheladin Murati, pedagog dhe ish-profesor universitar; Begzat Baliu nga Universiteti "Hasan Prishtina" në Prishtinë, Republika e Kosovës; Manjola Lumani nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës, Republika e Shqipërisë; Sejdi Gashi nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Republika e Kosovës; Ajten Hajdari-Qamili nga Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, si dhe Liljana Pandeva nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së.



21 shkurt 2022

Tryezë e Rrumbullakët
Tema: "Gjuha amtare, përfitim civilizues ose barrierë demokratike në shekullin XXI"

Të nderuar të pranishëm,

Është nder dhe kënaqësi e madhe që e pranuat ftesën për të qenë pjesë e tryezës së sotme, e cila mbahet në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare.

Ashtu si vitin e kaluar edhe këtë vit sërish e shënojmë këtë ditë të rëndësishme, 21 shkurtin, e cila është shpallur nga UNESCO-ja si Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare.



Gjuha është aftësi e lindur biologjike, por mësimi i saj është proces i përjetshëm. Është burim i pashtershëm që rrjedh dhe që duhet të kultivohet, të përmirësohet dhe të kujdesemi për pastërtinë e saj. Gjuha amtare jo vetëm simbolizon veçantinë e një populli, e një kulture, një historie, por shërben edhe për bashkimin e njerëzve dhe lidhjen kulturore të brezave që i ndërtojnë vlerat civilizuese në shoqëri.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si hapësirë në të cilën ndërthuren shumë gjuhë, kultura dhe religjione, është sinonim i diversitetit gjuhësor që përbën një bashkësi shoqërore të dallueshmërisë.

Në këtë kontekst, dallueshmëria e tillë, duhet parë si përfitim dhe jo si pengesë për përparimin shoqëror dhe kohezionin social. Gjuha e arsyes thyen të

gjitha barrierat, stereotipet dhe paragjykimet dhe është faktor për ndërveprim ndëretnik.

Sigurimi i kushteve për edukimin dhe shprehjen e gjuhës amtare në një mjedis demokratik duhet të jetë gjithmonë në interes të aktorëve shoqërorë, ndërsa sigurimi i respektimit të veçantisë gjuhësore të të gjitha etnive dhe gjuhëve të tyre duhet të jetë një nga prioritetet gjatë zbatimit të politikave gjuhësore. Gjuha amtare dhe përdorimi pa probleme i saj, është e drejtë themelore e çdo individi dhe pjekuria demokratike e një shteti, shihet në mënyrën dhe shkallën e realizimit të kësaj të drejte të garantuar me akte të shumta ndërkombëtare.

Sot, e festojmë këtë datë të rëndësishme për të shprehur respektin tonë për gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare në nivel institucional dhe gjuhë amtare e shumë qytetarëve në vendin tonë. Por jo vetëm njohja e gjuhës amtare, por edhe njohja e gjuhës së një bashkëqytetari nga një bashkësi tjetër etnike, kontribuon në kuptim më të mirë, bashkëpunim dhe lidhje më të madhe të kulturave të ndryshme përmes këtij mjeti të rëndësishëm - gjuhës si pasuria më e madhe shpirtërore e njeriut.

22 shkurt 2022

AZGJ-ja shënoi Ditën e Gjuhës Amtare me ekspozitën "Gjuha jonë sa e mirë"

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, mbrëmë në Qendrën Multimediale "Stacioni i Vogël" në Shkup u hap ekspozita "Gjuha jonë sa e mirë", të organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës.

Në fillim, dy violinistet e talentuara, Doriana Selmani dhe Elsa Azizi, ekzekutuan këngën e mirënjohur "Rrjedh në këngë e ligjërime". Pastaj të pranishmit i përshëndeti drejtori i AZGJ-së Ylber Sela i cili foli për rëndësinë e kësaj dite, si dhe për angazhimin e vazhdueshëm të AZGJ-së për zbatimin, mbrojtjen, kultivimin dhe afirmimin e gjuhës shqipe në të gjitha format e mundshme.

Po ashtu, me këtë rast pjesëmarrësit i përshëndeti edhe drejtori i Muzeut Historik Kombëtar të Tiranës, Dorian Koçi, ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fatos Reka dhe drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Skënder Asani.

Ndërkaq, fjalën e rastit për ekspozitën "Gjuha jonë sa e mirë" e mbajti historiania e artit, Amra Ismani e cila foli për përmbajtjen dhe domethënien e ekspozitës në fjalë.





JONË SA E MIRË

22 shkurt 2022

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet AZGj-së dhe Muzeut Historik Kombëtar

Komunikimi i vazhdueshëm ndërinstitucional i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj) me Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë (MHK) ka marrë një drejtim tjetër.



Me këtë rast, drejtori i AZGj-së, Ylber Sela priti homologun e tij të MHK-së, Dorian Koçi. Në kuadër të fushëveprimit të të dy palëve, sot në Shkup u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërinstitucional.



Nëpërmjet këtij bashkëpunimi synohet bashkërendimi i veprimeve për organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe të takimeve të ndryshme shkencore, shkëmbimi i ideve, i informacionit dhe i përvojave që lidhen me fushat e interesit të përbashkët të sferës së historisë së gjuhës shqipe.

22 shkurt 2022

Profesorët e Katedrës së Gazetarisë të UP-së vizituan AZGJ-në

Një grup profesorësh të Katedrës së Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, të kryesuar nga shefi i kësaj katedre, Muhamed Jahiri e vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, të cilët i priti drejtori Ylber Sela.

Me këtë rast ai i njoftoi ata lidhur me punën dhe angazhimin e përditshëm në aspektin e zbatimit zyrtar të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, si dhe për shumë çështje të tjera përkatëse.

Ndërkaq, për organizimin dhe strukturën e AZGJ-së që nga themelimi i saj e deri në momentin aktual, u foli këshilltari shtetëror i përkthimit në AZGJ, Nebi Bilalli.





23 shkurt 2022

AZGJ-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, prof. dr. Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij bëri një vizitë zyrtare në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, ku u prit nga rektori prof. dr. Dhimitri Bello me bashkëpunëtorët e tij, si dhe pedagogë të tjerë të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë në suaza të këtij universiteti. Gjatë këtij takimi u shkëmbyen mendime e ide për bashkëpunim në fushën e gjuhës, si dhe për shumë çështje të tjera me interes të përbashkët.



Me këtë rast, dy drejtuesit e këtyre institucioneve nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi e cila parasheh projekte të përbashkëta në fushën e gjuhësisë, pjesëmarrje në konferenca shkencore, mbështetje të ndërsjella për vepritmari të ndryshme gjatë bashkëpunimit etj.

Para të pranishmëve, prezentimin e AZGJ-së që nga fillimi e deri më sot, e bëri këshilltari shtetëror i përkthimit në këtë institucion, Nebi Bilalli.

Në suaza të kësaj vizite, po ashtu u prezentua edhe libri "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve", të botuar nga AZGJ-ja, për të cilin foli ligjëruesi i Universitetit të Tetovës, prof. dr. Jusuf Zejneli. Me këtë rast nga drejtuesit dhe pedagogët e këtij universiteti u shtruan edhe pyetje lidhur me disa probleme, si dhe u zhvillua një diskutim i frytshëm.

24 shkurt 2022

Hekurudhat – Transport filluan bashkëpunimin me AZGJ-në

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut Transport SHA – Shkup ku u takua me z. Mubekir Palloshi, Drejtor i Përgjithshëm dhe Kryetar i Këshillit Drejtues të Shoqërisë Aksionare.

Në këtë mbledhje u shqyrtua gjendja rreth zbatimit të dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e kësaj shoqërie aksionare.



Drejtori Palloshi u falënderua për nismën e AZGJ-së për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mundësinë e shkëmbimit të drejtpërdrejtë të mendimeve për sqarimin e çështjeve të caktuara, që dalin nga zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Njëkohësisht, ai theksoi se është i padiskutueshëm respektimi i dispozitave ligjore dhe se shoqëria aksionare do të ndërmarrë aktivitete për përmbushjen e detyrimeve ligjore, për të cilat do të angazhohen plotësisht, me ndihmën edhe të AZGJ-së.

Nga ana tjetër, drejtori Sela, ofroi mbështetje të plotë në fushën e konsultimeve profesionale, përkthim dhe lekturim të akteve të përgjithshme dhe formularëve të shoqërisë aksionare, si dhe dorëzoi një sërë botimesh të botuara nga AZGJ-ja.

1 mars 2022

AZGJ-ja vendosi bashkëpunim ndërinstitucional me NP HRMV – Infrastrukturë

Pas vizitës së javës së kaluar Hekurudhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut Transport SHA – Shkup, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, sot e vizitoi edhe Ndërmarrjen Publike të Infrastrukturës Hekurudhore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku kishte vizitë pune me z. Hari Llokvenecin, drejtor i përgjithshëm i ndërmarrjes publike dhe me z. Nevzat Mamutin, ndihmësdrejtor për punë të përgjithshme.



Vizita u realizua me nismë të drejtorit Sela, për shkak të këqyrjes së gjendjes rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e ndërmarrjes publike, si dhe shqyrtimit të mënyrave për bashkëpunim në interes të realizimit dhe zbatimit të shpejtë të detyrimeve ligjore.

Drejtori Llokvenec e informoi drejtorin Sela rreth aktiviteteve të ndërmarra të deritanishme, përditësimit të planifikuar të faqes zyrtare të internetit të ndërmarrjes për shkak të qasjes tek informatat edhe në gjuhën shqipe, si dhe aktivitetet e planifikuara për përshtatjen gjuhësore të infrastrukturës hekurudhore në komunat ku së paku 20% të qytetarëve e flasin gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare, si dhe në Shkup. Njëkohësisht, theksoi se pret ndihmë profesionale nga AZGJ-ja në pjesën e terminologjisë gjuhësore dhe të lekturës.

Drejtori Sela theksoi se ndërmarrja publike mund të presë nga AZGJ-ja mbështetje të plotë dhe që është e hapur për bashkëpunim në çdo kohë, në interes për qytetarët si shfrytëzues të transportit hekurudhor.

2 mars 2022

Takim ndërinstitucional me Klinikën Universitare të Kirurgjisë së Fëmijëve

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi IShP Klinikën Universitare të Kirurgjisë së Fëmijëve në Shkup.

Ata u pritën nga drejtori i kësaj klinike, Elmedin Asani. Me këtë rast Sela e Asani biseduan për nivelin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion të shëndetit publik.



Gjatë këtij takimi u konstatua se drejtori Asani ka ndërmarrë veprime konkrete dhe ka avancuar përdorimin e gjuhës shqipe në institucionin që ai drejton.

Palët u zotuan për të thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional nëpërmjet ndihmës konkrete që drejtori Sela i ofroi këtij institucioni në përkthimin dhe lektorimin e materialeve të rëndësishme siç e parasheh Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

2 mars 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela vizitoi Institutin e Mjekësisë së Punës

Në suaza të vizitave dhe takimeve me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela e vizitoi edhe Institutin e Mjekësisë së Punës të RMV-së, ku u takua me drejtorin e këtij institucioni, Aziz Maksutin. Me këtë rast ata biseduan për përpjekjet dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore.



Megjithëse ky institucion mund të merret si shembull i zbatimit të dygjuhësisë, drejtori Aziz Maksuti kërkoi ndihmën e AZGJ-së edhe për përkthimin dhe lekturimin e disa dokumenteve dhe shkresave të tjera të cilat duhet të bëhen në dy gjuhë.

Lidhur me këtë, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela u zotua se do ta mbështesë në çdo gjë që ka të bëjë me zbatimin e gjuhës shqipe në këtë institucion.

Të dy homologët u zotuan që ta vazhdojnë bashkëpunimin për sa i përket zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

3 mars 2022

Takim bashkërendues me përfaqësues nga institucionet publike

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) priti sot të caktuarit e mbi njëqind institucioneve publike të cilët do të merren me promovimin dhe avancimin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ky aktivitet bazohet në nenin 19 të këtij ligji që parasheh promovimin dhe ndërmarrjen e masave për avancimin e mëtutjeshëm të tij.

Me këtë rast përfaqësuesit e institucioneve patën rastin të dëgjojnë drejtpërdrejt drejtorin e AZGJ-së, Ylber Selën, i cili bëri një prezantim të institucionit përkatës dhe të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Më tej, drejtori dha sqarime konkrete rreth kompetencave ligjore që ka Agjencia dhe mënyrën se si ndihmon institucionet shtetërore në përdorimin e gjuhës shqipe, si gjuhë e dytë zyrtare, në shkresat e ndryshme të tyre.



Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e institucioneve patën rastin të parashtrojnë pyetje të ndryshme rreth dilemave dhe sfidave me të cilat përballen gjatë punës së tyre zyrtare, ndërkaq drejtori u përgjigj për të gjitha këto në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme për të interesuarit.

Pjesë e debatit ishin edhe disa aspekte terminologjike me të cilat përballen këta përfaqësues të cilët kanë të marrin përsipër promovimin dhe avancimin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Drejtori Sela kërkoi që të gjithë përfaqësuesit, kurdo që hasin në vështirësi të ndryshme, t'i drejtohen AZGJ-së për këshilla të cilat do t'u ndihmojnë të tejkalojnë çdo vështirësi të tyre.

4 mars 2022

Takim konsultues me drejtorin e Parkut Nacional “Mali Sharr”

Në kuadër të veprimeve mbështetëse që drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela realizon me drejtues të institucioneve të ndryshme, kësaj radhe u realizua një takim me drejtorin e Parkut Nacional “Mali Sharr”, Ibrahim Deari.



Me këtë rast, Sela dhe Deari diskutuan për çështjet që ndërlidhen me dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe zbatimin e tyre në institucionin që Deari drejton.

Drejtori Sela konfirmoi edhe një herë që dyert e Agjencisë janë të hapura për të gjitha institucionet, e sidomos për të këtilla si Parku Nacional që është në ngritje e sipër.

7 mars 2022

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në promovimin e librit "Propozime për drejtshkrimin " të autorit Rami Memushaj

Të nderuar miq!

Sot kam nderin dhe kënaqësinë t'ju përshëndes në këtë përvjetor shumë të rëndësishëm për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë e veprojnë, kudo që marrin frymë e mendojnë shqip, përvjetor ky që lidhet me një periudhë të rëndësishme të zhvillimit dhe emancipimit tonë kulturor e kombëtar, pra me 50 vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, që sot fillon të shënohet me këtë aktivitet i cili ka të bëjë me promovimin e librit "Propozime për drejtshkrimin" të autorit dhe bashkëpunëtorit tonë, Rami Memushaj.



Në të vërtetë, ky vit me të drejtë është shpallur si Vit i Drejtshkrimit, për arsye se do të shënohet në mënyrë institucionale me një varg aktivitetesh të ndryshme kulturore e shkencore. Pa dyshim, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së është zotuar se do të jetë pjesë dhe partner i këtyre aktiviteteve për të dhënë ndihmesën e saj, aq më tepër për arsye se veprimtaria e saj është kryekëput gjuha shqipe dhe zbatimi i saj zyrtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me përcaktimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Kjo nënkupton faktin se detyrë dhe imperativ i kësaj agjencie është zbatimi i normës standarde, përkatësisht i drejtshkrimit të saj, duke e bërë çdo ditë gjatë

përkthimit dhe lekturimit të akteve, dokumenteve e shkresave të shumta zyrtare.



Prandaj, edhe ky libër i Rami Memushajt që vjen në 50 vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit është plotësisht në përputhje me punën dhe vokacionin tonë. Në këtë kuptim, ne e ndjejmë këtë si pjesë tonën, duke e konsideruar si një arritje historike e kombëtare, si kujtesë dhe si dëshmi, por edhe si vizion e angazhim i vazhdueshëm. Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksojmë faktin se me anë të drejtshkrimit, ne ndihemi më të bashkuar e më të konsoliduar në aspektin kulturor, arsimor, gjuhësor e kombëtar. Duke folur e shkruar sipas standardit të kësaj gjuhe, ne realisht flasim me një zë të përbashkët, komunikojmë në mënyrë shumë qytetëruese dhe moderne.

Pa e zgjatur më shumë, uroj që ky libër të mbetet si një testament gjuhësor për të gjithë shqiptarët, veçanërisht për ne që merremi me zbatimin zyrtar të gjuhës shqipe, si dhe për të gjitha institucionet arsimore, kulturore e shkencore.

Ju faleminderit!

8 mars 2022

Vizitë punë Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë

Pas vizitës së Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë në muajin tetor 2019, sot u realizua vizitë e re nga ana e drejtorit të AZGj-së, Ylber Sela në kuadër të së cilës kishte takim pune me drejtorin e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, z. Nikollçe Babovskin.

Në takim drejtori Sela theksoi se është vërejtur ndërprerje në zbatimin e detyrimeve të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, se përveç tabelës dhe vulës, të cilat janë ndërruar, mbeten edhe aktivitete të tjera të cilat duhet të bëhen me qëllim harmonizimin me detyrimet ligjore.



Drejtori Sela e përshëndeti gatishmërinë për bashkëpunim të drejtorit Babovski dhe e informoi atë se AZGj-ja është e hapur për bashkëpunim me AUV-në në aspektin e ndihmës profesionale për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, si përkthimin dhe lekturimin e akteve të përgjithshme dhe formularëve, të cilat dalin nga puna vijuese e Agjencisë së Ushqimit dhe e Veterinarisë.

Drejtori Babovski theksoi se në institucionin të cilin e udhëheq, mungojnë burime njerëzore për përkthim të dokumenteve zyrtare nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas dhe në këtë drejtim kërkon ndihmë nga AZGj-ja, gjithashtu e falënderoi për qasjen pozitive dhe gatishmërinë për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve.

8 mars 2022

Vendosje e bashkëpunimit me PLP-në Shkup dhe PThP-në Shkup

Në kuadër të agjendës intensive të punës së sotme, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela realizoi takim edhe në Prokurorinë e Lartë Publike, Shkup dhe me Prokurorinë Themelore Publike, Shkup, ku realizoi takim me udhëheqësit e këtyre dy institucioneve, z. Mustafa Hajrullahi dhe z. Gavril Bubevski.



.

Në takim drejtori Sela theksoi se e rëndësisë parësore është zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e prokurorive publike të të gjitha niveleve dhe që AZGj-ja është e hapur për bashkëpunim, këmbim të mendimeve dhe konsultime profesionale. Njëherësh, theksoi se AZGj-ja përgatit botim që do ta përfshijë përdorimin e gjuhëve, me theks të veçantë sektorin gjyqësor dhe i njëjti planifikohet të promovohet së shpejti.

Nga ana tjetër u konstatua se ka gjendje të pavolitshme me ekipimin e burimeve njerëzore për përkthim dhe lekturim të akteve zyrtare dhe në këtë pjesë u dakorduan aktivitete që duhet të merren që të tejkalohet gjendja e këtillë dhe të mundësohet funksionimi i pandërprerë i këtyre dy prokurorive.

8 mars 2022

Gjuha shqipe do të zbatohet edhe në shëndetësi

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, realizoi një takim pune me ministrin e Shëndetësisë, Bekim Sali.

Me këtë rast, drejtori Sela ofroi mbështetjen e plotë të AZGj-së për të përkthyer dhe për të lektoruar të gjithë formularët të cilët përdoren nga kjo ministri dhe gjenerohen nga softuerët e ndryshëm.



Nga ana tjetër, edhe ministri Sali mirëpriti mbështetjen e ofruar nga drejtori Sela dhe u zotua se do të ndërmerren hapa konkret në drejtim të zbatimit të dispozitave që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

Shëndetësia është një nga sferat ku zbatimi i këtij ligji ka ngecur, andaj ky takim do të shërbejë si shtytje në drejtimin e duhur.

9 mars 2022

Drejtori Sela takoi zëvendësministrin Doko dhe drejtorin Kurtish

Sot në zyrat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), drejtori Sela priti Xhabir Dokon, zëvendësministër i Sistemit Politik dhe i Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive dhe Eran Kurtish, drejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive.



Me këtë rast, Doko e Kurtish u njoftuan me veprimtarinë konkrete të AZGJ-së si dhe shprehën interesimin e tyre për bashkëpunim ndërinstitucional që ndërlidhet me aspekte gjuhësore.

Drejtori Sela mirëpriti interesimin e tyre dhe u zotua për mbështetje konkrete në rastet kur AZGj-ja është e domosdoshme të ndihmojë.

10 mars 2022

Për të dytin vit me radhë AZGJ-ja mban trajnimin e administratorëve public

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës nga dita e hënë do të fillojë me trajnimin e rreth 80 përkthyesve dhe lektorëve të institucioneve të ndryshme të administratës. Drejtori i Agjencisë, Ylber Sela dhe koordinatorja e këtij trajnimi Shpresa Zeqiri Ibrahimi pritën kandidatët për t'u njohur nga afër me ta dhe me rrjedhën e këtij trajnimi.

Me këtë rast drejtori Sela theksoi nevojën e rregullshmërisë në ndjekjen e këtij trajnimi, duke pasur parasysh problemet e shpeshta që hasin në dokumentet e ndryshme gjatë përdorimit të gjuhëve, veçanërisht të terminologjisë, prej nga lind edhe nevoja për harmonizim të saj me gjuhën që përdoret në administratë. Qëllimi i këtij trajnimi, tha Sela, është përshtatur sipas nevojave të përkthyesve dhe të lektorëve të të gjithë institucioneve, të organeve të administratës, së pari të ministrive, të ndërmarrjeve publike dhe të gjykatave, për çka janë angazhuar profesorët më të shquar nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria.



Shpresa Zeqiri Ibrahimi, koordinatorja e këtij trajnimi, kumtoi se trajnimet do të mbahen në 6 grupe me nga 15 kandidatë, ku do të trajtohen tema të ndryshme nga fusha e përkthimit, si një ndihmesë praktike në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në RMV.

Drejtori Sela kërkoi nga të gjithë pjesëmarrësit, kurdo që hasin në vështirësi të ndryshme, t'i drejtohen AZGJ-së për këshilla të cilat do t'u ndihmojnë për të tejkaluar çdo vështirësi të tyre.

14 mars 2022

Filloi trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të administratës publike

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) filloi trajnimi i dy grupeve të para të përkthyesve dhe të lektorëve të Administratës Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV).

Në këtë cikël të dytë me radhë marrin pjesë rreth nëntëdhjetë nëpunës të institucioneve të ndryshme, të ndarë në gjashtë grupe.

Trajnimin e hapi drejtori i AZGj-së, Ylber Sela i cili kërkoi nga administratorët që të jenë të vëmendshëm dhe të mundohem të përfitojnë sa më shumë.

Ligjëruesit e parë janë Xhevat Lloshi i cili ka përgatitur modulin e stilistikës të përshtatur sipas nevojës së administratës publike dhe Rami Memushaj i cili ka përgatitur modulin e semantikës, gjithashtu të përshtatur sipas nevojës së administratës publike.





15 mars 2022

Mbështetje institucionale për DHP-në

Pas disa kërkesave zyrtare, sot u realizua një takim pune ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj) dhe Drejtorisë së të Hyrave Publike (DHP).

Me këtë rast, drejtori i AZGj-së Ylber Sela ofroi mbështetjen institucionale siç e parasheh Ligji i Përdorimit të Gjuhëve që edhe në këtë drejtori të fillojë zbatimi konkret i këtij ligji.



Nikoqirët, përgjegjësit e çështjeve juridike u interesuan për disa pika konkrete të ligjit për të cilat kishin paqartësi.

Pasi sqaroi çështjet konkrete, drejtori Sela u zotua për mbështetje të drejtpërdrejtë në përkthimin e formularëve të ndryshëm, duke filluar nga ato që përdoren më së shpeshti.

15 mars 2022

Takim zyrtar me drejtorin e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela priti në takim, Hulusi Beqirin, drejtor i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës.

Me këtë rast, Sela dhe Beqiri diskutuan për sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet përkatëse.



Drejtori Sela konfirmoi mbështetjen e AZGJ-së për këtë agjenci, duke theksuar që AZGJ-ja është në dispozicion të çdo institucioni që ka nevojë për mbështetje gjuhësore.

21 mars 2022

Takim ndërinstitucional me Fondin e Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik

Sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, realizoi një takim pune me Fondin e Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik (FIZhT), ku u prit nga homologu i vet, Festim Halili.

Ky takim është në shërbim të mbështetjes që AZGj-ja ua ofron të gjitha institucioneve publike të vendit.



Me këtë rast, Sela dhe Halili biseduan për bashkëpunim ndërinstitucional në sferën e gjuhësisë. Konkretisht u fol për konsultime rreth aspekteve terminologjike dhe të përkthimit të formularëve dhe të dokumenteve të tjera të cilat Agjencia merr përsipër që t'ia përkthejë Fondit.

Palët ranë dakord që të vazhdojnë komunikimin dhe bashkëpunimin e mëtejmë.

21 mars 2022

Takim ndërinstitucional me NP-në Pyjet Nacionale

Sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, realizoi një takim pune me NP-në Pyjet Nacionale, ku u prit nga homologu i vet, Juliana Nikollovska dhe zëvendësdrejtori Berat Dehari.



Me këtë rast, bashkëbiseduesit diskutuan për sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet përkatëse.

Drejtori Sela konfirmoi mbështetjen e AZGJ-së për këtë institucion, duke theksuar që AZGJ-ja është në dispozicion të çdo institucioni që ka nevojë për mbështetje gjuhësore.

22 mars 2022

Java e dytë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve të institucioneve publike

Këtë javë ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike të vendit.

Temat e kësaj jave të dytë janë aspektet terminologjike për të cilat ligjëron profesori Ismet Osmani, ndërkaq për aspektet gramatikore gjatë përkthimit ligjëron profesori Asllan Hamiti.

Trajnimi është i projektuar në format temash, pra për çdo javë ka nga dy tema për të cilat ligjërojnë dy njohës të gjuhës shqipe dhe të çështjeve të përkthimit.





23 mars 2022


Angazhimi i konfirmuar për përmirësimin e gjendjes së zbatimit të gjuhëve zyrtare në Klinikën e Pulmologjisë dhe të Alergologjisë

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, sot realizoi takim pune në ISHP Klinikën Universitare të Pulmologjisë dhe të Alergologjisë ku u takua me drejtorët e klinikës, prof. dr. Dejan Dokiq dhe Suat Shaqiri.

Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i gjendjes rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve gjatë funksionimit të klinikës.

Drejtori Sela theksoi se është i kënaqur që menaxhmenti i klinikës në fjalë është i hapur për bashkëpunim me AZGJ-në me interes të zbatimit të dispozitave ligjore, për çfarë janë ndërmarrë aktivitete për ndryshimin e tabelave, vulës zyrtare, vulave katrore, memorandumit të akteve zyrtare të klinikës etj. Njëkohësisht, ai u dorëzoi edhe publikime të AZGJ-së dhe shprehu gatishmëri për bashkëpunim rreth përkthimit dhe lekturimit të akteve të përgjithshme, vërtetimeve, formularëve që i përgatit kjo klinikë.

Të dyja palët u dakorduan për bashkëpunim të mëtejshëm në interes të pacientëve si përdorues të fundit të shërbimeve shëndetësore





23 mars 2022

NP Parkingu i Qytetit - Shkup do të bashkëpunojë me AZGJ-në

Në kuadër të agjendës së sotme intensive të punës, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, vizitoi Ndërmarrjen Publike Parkingu i Qytetit – Shkup ku u takua me Bojan Hristovskin, drejtor i ndërmarrjes publike dhe me zëvendësin e tij, Isa Idrizi.

Me këtë rast, Sela dhe Hristovski biseduan rreth gjendjes në ndërmarrjen publike për sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe shkallës së realizimit të detyrimeve të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Drejtori Sela ofroi mbështetje në aspektin e përkthimit dhe të lekturimit të formularëve dhe të akteve të tjera të përgjithshme që dalin nga puna e ndërmarrjes publike, si dhe u shpreh i hapur për bashkëpunim për çështjet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit në fjalë.

Takimi është në shërbim të mbështetjes që AZGJ-ja u jep institucioneve publike për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.


24 mars 2022


AZGj-ja vazhdon me angazhimet e bashkëpunimit më të madh me Delegacionin e BE-së

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela realizoi takim online me Sabri Tahir, zyrtar i çështjeve politike në Delegacionin e BE-së në Shkup.

Drejtori Sela e falënderoi për mundësinë e takimit dhe e njoftoi bashkëfolësin e tij për punën e deritashme të AZGj-së, si dhe për projektet e realizuara, ndërsa njëkohësisht konstatoi se ekziston hapësira për bashkëpunim më të madh me Delegacionin e BE-së, për çka propozoi disa projekte që do të mund të realizoheshin me përpjekje të përbashkëta.

Nga ana tjetër, Tahir u falënderua për prezantimin e hollësishëm të punës së AZGj-së dhe u zotua për vazhdimin e komunikimit me AZGJ-në nëpërmjet realizimit të takimit të ri në selinë e AZGj-së, në të cilën do të bisedohej rreth temave që ishin pjesë e diskutimit në takimin e sotëm online.





29 mars 2022

Përkrahje institucionale për Agjencinë e Mbështetjes së Sipërmarrësisë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela realizoi takim konsultues me drejtorin e Agjencisë së Mbështetjes së Sipërmarrjes (AMS), Hajrulla Misini.

Homologët diskutuan për nivelin e zbatimit të dispozitave që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.



Çështje tjetër që u diskutua ishte edhe thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet mbështetjes konkrete të AZGJ-së për AMS-në për përkthimin dhe lektorimin e formularëve të ndryshëm që AMS-ja i ka në shfrytëzim.

Palët u dakorduan që takimet e këtilla të vazhdojnë edhe më tej.

30 mars 2022

Takim ndërinstitucional në Drejtorinë e Evidencës së Librave të Amzës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela realizoi një takim me drejtorin e Drejtorisë së Evidencës së Librave të Amzës (DMLA), Blerim Abazi.



Homologët biseduan për çështjen e rëndësishme të regjistrimit të qytetarëve të kombësisë shqiptare në librat e amzës si një problem i kahershëm sepse shënimi i emrave të tyre është bërë vazhdimisht me gabime të shumta.

Me këtë rast, Sela dhe Abazi u zotuan për bashkëpunim që të gjendet një zgjidhje për këtë çështje dhe regjistrimi i qytetarëve të jetë sa më i saktë.

30 mars 2022

Takim ndërinstitucional në Ministrinë e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Ekonomisë së Ujërave

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela realizoi një takim me zëvendësministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Ekonomisë së Ujërave, Abdylshyqyr Abedinin.

Ky takim shërbeu për t'u njohur nga afër me nivelin e zbatimit të dispozitave që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.



Me këtë rast, Sela dhe Abedini u zotuan për bashkëpunim në sferën e përkthimit dhe të lektorimit të materialeve që sipas Ligjit, Agjencia duhet t'ua ofrojë institucioneve publike.

30 mars 2022

AZGj-ja dhe Misioni i OSBE-së në Shkup do të realizojnë trajnim për përkthim simultan

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela realizoi takim pune me përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Shkup, të udhëhequr nga Katarina Zhivkoviq, asistente e programit të Misionit.

Temë e diskutimit ishte vazhdimi i bashkëpunimit të shkëlqyeshëm mes dy palëve dhe zbatimi i aktivitetit të ri dhe të përbashkët, që është në plan të realizohet gjatë muajit maj. Bëhet fjalë për trajnim disaditor për përmirësimin e aftësive për përkthim simultan, që është i paracaktuar për nëpunësit e Sektorit të përkthimit dhe të lekturimit të AZGj-së.



Me mbështetjen e Misionit të OSBE-së do të sigurohet ndihmë nga ekspertët për realizimin e trajnimit, prej të cilëve dy trajnues më me përvojë të kësaj fushe, Blerina Starova Zllatku dhe Llukrecija Malkoviq Atanasovska.

Drejtori Sela i falënderoi për mbështetjen e deritanishme nga ana e Misionit të OSBE-së dhe theksoi se zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta projektuese, që janë të identifikuara si prioritare, janë me rëndësi të veçantë për institucionin dhe për atë qëllim, AZGj-ja gjithmonë do të jetë e hapur për bashkëpunim.

31 mars 2022

U promovua botimi shkencor "Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut"

Dje, në amfiteatrin e Universitetit të Europës Juglindore në Shkup, u promovua punimi shkencor "Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut" të autorëve prof. dr. Ylber Sela dhe mr. Llazo Matovski.

Promovimi i punimit shkencor u organizua nga ana e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Europës Juglindore dhe Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Tetovës.

Gjatë promovimit të këtij publikimi fjalë rasti kishin prof. dr. Adnan Jashari, dekan i Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Europës Juglindore dhe prof. dr. Qebir Avziu, dekan i Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Tetovës.

Gjithashtu, fjalë rasti kishin dhe recensentët e këtij publikimi shkencor prof. dr. Jeton Shasivari dhe prof. dr. Afet Mamuti.
Në fund, fjalë rasti kishin dhe autorë e këtij publikimi, prof. dr. Ylber Sela dhe mr. Llazo Matovski.

"Të udhëhequr nga mendimi për t'u shqyrtuar aspektet ligjore të përdorimit të gjuhëve në një fushë sociale më specifike, siç është gjyqësori, në periudhën e kaluar jemi përpjekur t'i trajtojmë situatat në lidhje me përdorimin e gjuhëve në sistemin e gjyqësorit si një nga shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat bazohet çdo bashkësi shoqërore. Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve të garantuara me kushtetutë dhe me ligj, përfshirë të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre në procedurat para institucioneve gjyqësore, është jo vetëm e drejtë, por edhe nevojë për realizimin real të tyre të çdo qytetari që ka nevojë, pavarësisht nëse qytetari është palë apo mund të paraqitet në ndonjë cilësi tjetër në ndonjë procedurë të caktuar. Jemi të vetëdijshëm se ekzistojnë një sërë sfidash me të cilat përballet sistemi i gjyqësorit, fushë në të cilën diskutohet vazhdimisht nevoja për reforma të nevojshme që duhet t'i përmirësojnë dhe avancojnë situatat." – theksoi prof. dr. Ylber Sela.

"Ky punim u referohet aspekteve materiale dhe proceduralo-juridike të përdorimit të gjuhëve në sistemin juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë në rregullimin e tyre ligjor dhe përdorimin në organet gjyqësore, me theks edhe të akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, që u referohen përdorimit të gjuhëve dhe të drejtës së mosdiskriminimit gjuhësor.

Zbatimi i gjuhëve në sektorin gjyqësor për shkak të realizimit të angazhimeve pa pengesa të lirive dhe të drejtave të garantuara të qytetarit si palë, është proces i përmbushur me vështirësi dhe sfida të natyrës objektive dhe subjektive, si dhe mungesë e burimeve të natyrës materialo-teknike dhe atij me kuadër.” – theksoi mr. Llazo Matovski.

Kjo ngjarje përkoi me shënimin e Ditës së Gjyqësorit, duke qenë se temë kryesore e publikimit është sistemi gjyqësor dhe përdorimi i gjuhëve në proceset para institucioneve gjyqësore.









31 mars 2022

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela me rastin e promovimit të botimit shkencor "Aspektet ligjore të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut"

Të nderuara zonja dhe zotërinj,
të nderuar anëtarë të komunitetit akademik, të nderuar kolegë,
të nderuar përfaqësues të institucioneve, medieve,
të nderuar të pranishëm,

Kam nderin që së bashku me ju kemi mundësinë ta promovojmë punimin shkencor me titullin punues "Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

Promovimi i këtij punimi përkon me shënimin e Ditës së Gjyqësorit, duke pasur parasysh se temë kryesore e punimit është sistemi gjyqësor dhe përdorimi i gjuhëve në proceset para institucioneve gjyqësore.

Të udhëhequr nga mendimi për t'u shqyrtuar aspektet ligjore të përdorimit të gjuhëve në një fushë sociale më specifike, siç është gjyqësori, në periudhën e kaluar jemi përpjekur t'i trajtojmë situatat në lidhje me përdorimin e gjuhëve në sistemin e gjyqësorit si një nga shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat bazohet çdo bashkësi shoqërore.



Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve të garantuara me kushtetutë dhe me ligj, përfshirë të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre në procedurat para institucioneve gjyqësore, është jo vetëm e drejtë, por edhe nevojë për realizimin real të tyre të çdo qytetari që ka nevojë, pavarësisht nëse qytetari është palë apo mund të paraqitet në ndonjë cilësi tjetër në ndonjë procedurë të caktuar.

Jemi të vetëdijshëm se ekzistojnë një sërë sfidash me të cilat përballet sistemi i gjyqësorit, fushë në të cilën diskutohet vazhdimisht nevoja për reforma të nevojshme që duhet t'i përmirësojnë dhe avancojnë situatat.

Le të jetë ky punim motiv për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për realizimin e njërës prej sfidave të tilla, e që është Ligji i Përdorimit të Gjuhëve në sistemin gjyqësor.

Në fund, dëshiroj ta falënderoj bashkautorin mr. Lazo Mateskin për përkushtimin dhe bashkëpunimin në procesin e përgatitjes së punimit, recensentët prof. dr. Jeton Shasivarin dhe prof. dr. Afet Mamutin për kontributin dhe recensionin e tyre, si dhe ekipin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, të cilët ndihmuan që ky punim të dalë në dritë.

Shpresoj që punimi do të ketë jehonë pozitive te lexuesit.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Fjalimi i autorit, Llazo Matovski me rastin e promovimit të botimit shkencor "Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut"

Të nderuara zonja dhe zotërinj,
të nderuar anëtarë të komunitetit akademik,
të nderuar pjesëmarrës të institucioneve, medie,
të nderuar të pranishëm,

Jam i nderuar dhe veçanërisht i kënaqur që pranuat ftesën për të marrë pjesë në promovimin e sotëm të librit "Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

Pa mos e zgjatur shumë, do të doja të ndërlidhesha me prononcimin e bashkautorit të këtij libri prof. dr. Ylber Sela.

Jo rastësisht është zgjedhur dita e sotme – Dita e gjyqësorit për promovimin e këtij punimi, duke pasur parasysh se e shqyrton tematikën e përdorimit të gjuhëve në procedurat para organeve gjyqësore.

Motivi themelor dhe pikënisja e përpilimit të një punimi të këtillë ishte gjendja aktuale e lidhur me zbatimin e gjuhëve në sistemin legjislativ dhe ndjenja e nevojës që të ndërmerren aktivitete, përkatësisht të riafirmohet interesi i zbatimit të rregullave pozitive ligjore, të cilat e rregullojnë përdorimin e gjuhëve në këtë fushë të rëndësishme shoqërore.

Ky punim u referohet aspekteve materiale dhe proceduralo-juridike të përdorimit të gjuhëve në sistemin juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë në rregullimin e tyre ligjor dhe përdorimin në organet gjyqësore, me theks edhe të akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, që i referohen përdorimit të gjuhëve dhe të drejtës së mosdiskriminimit gjuhësor.

Zbatimi i gjuhëve në sektorin gjyqësor për shkak të realizimit të angazhimeve për pasjen e papengueshme dhe faktik të lirive dhe të drejtave të garantuara të qytetarit si palë është proces i plotësuar me vështirësi dhe sfida të natyrës objektive dhe subjektive, si dhe mungesë e burimeve të natyrës materialo-teknike dhe kadrovike.



Sistemi gjyqësor padyshim që paraqet një nga shtyllat themelore të sistemit institucional dhe vendosjen e sistemit efikas funksional, që mëton drejt realizimit të funksionit të tij të drejtësisë efektive, cilësore dhe të barabartë dhe është postulat i rëndësishëm i parimit të sundimit të së drejtës në bashkësinë shoqërore të bazuar në respektimin e vlerave qytetëruese bashkëkohore.

Sigurisht, këtë libër e shoh si nxitje e veprimit institucional më gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të përfshirë, me qëllim për të krijuar kushte të zbatimit real dhe praktik të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në sistemin gjyqësor.

Në fund, më lejoni që ta falënderoj bashkautorin prof. dr. Ylber Sela, për bashkëpunimin konstruktiv në procesin e përpilimit të librit, recensuesve prof. dr. Jeton Shasivari dhe prof. dr. Afet Mamuti, për vëzhgimin kritik të punimit, kolegëve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, të cilët dhanë kontributin e tyre të rëndësishëm në përgatitjen e këtij libri, bashkëpunëtores Daniella Jaqimovska, lektorëve dr. Liljana Pandeva, Ahmet Selmani dhe Nebi Bilalli, si dhe kolegët që ndihmuan në përpilimin e librit: Elham Hajrullahu, Rihan Ismaili, Behar Rushit, Suhejb Mustafa, Elif Musai, Sali Etemi, Kushtrim Saiti dhe Dardan Emini.

Shpresoj që ky libër do ta gjejë rrugën e vet deri te lexuesi dhe të ketë jehonë pozitive te lexuesit.

Ju faleminderit!

6 prill 2022

Konfirmohet bashkëpunimi ndërinstitucional me FSPI-në

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, realizoi një vizitë pune në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor (FSPI), ku u prit nga drejtori i këtij institucioni, Dritan Bexheti, zëvendësdrejtori Shaip Zeneli dhe ekipi i tyre.

Me këtë rast u konfirmua bashkëpunimi i ngushtë ndërinstitucional që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Dy institucionet përcaktuan pikat e radhës të ndihmës profesionale që AZGj-ja do t'i ofrojë FSPI-së në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimet e nevojshme edhe në gjuhën shqipe.

8 prill 2022


Mbaroi java e tretë dhe e katërt e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së tretë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, Teknologjitë e përkthimit, ligjëroi Arsim Jonuzi, ndërkaq për temën e dytë, Përkthimi i teksteve politike, ligjëroi Zeqirja Ibraimi.

Edhe gjatë javës së katërt u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, Të shkruarit ligjor, formularë, kërkesa, ligjëroi Bashkim Selmani, ndërkaq për temën e dytë, Përkthimi i teksteve juridike, ligjëroi Afet Mamuti.

Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.





12 prill 2022

AZGj-ja dhe Komuna e Gazi Babës nisin bashkëpunimin e ndërsjellë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij vizitoi Komunën e Gazi Babës, ku pati takim pune me kryetarin Boban Stefkovskin.



Në këtë takim u diskutuan të dhënat e publikuara së fundmi nga regjistrimi i popullsisë, i amvisërive dhe i banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me të dhënat në komunën e Gazi Babës, ku krahas gjuhës maqedonase, edhe shqipja bëhet zyrtare.

Drejtori Sela i falënderoi për mundësinë e takimit dhe i ofroi ndihmë dhe mbështetje kryetarit Stefkovski për të filluar zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në komunë, me udhëzime konkrete se si të fillojë dhe të drejtohet ky proces në fazën e parë.

Nga ana tjetër, kryetari Stefkovski shprehu gatishmëri dhe vullnet për të realizuar atë që është detyrim ligjor dhe pret përkrahje dhe bashkëpunim ndërmjet dy palëve për realizimin e mëtutjeshëm me sukses të këtij procesi.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se komunikimi ndërinstitucional do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, me dinamikë të shtuar, në interes të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe të realizimit të të drejtave të qytetarëve të komunës së Gazi Babës që e flasin gjuhën shqipe.

15 prill 2022

Mbaroi java e pestë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së pestë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, Fjalët dhe shprehjet e huaja në gjuhën shqipe, ligjëroi Manjola Lumani Zaçellari, ndërkaq për temën e dytë, Përkthimi i teksteve letrare, ligjëroi Berton Sulejmani.

Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.





15 prill 2022

Ligjëratë e profesorit Zylyftar Bregu në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) qëndroi Zylyftar Bregu, profesor në Universitetin e Tetovës dhe atë të Tiranës në degën e gazetarisë.

Me këtë rast, profesor Bregu mbajti një ligjëratë të përgatitur enkas për nëpunësit e AZGj-së, tema e së cilës ishte "Gjuha, mesazhi dhe media".

Çështje trajtimi në këtë temë ishin raportet midis informacionit, gjuhës dhe medias dhe sa të ndërvarura janë këto për të realizuar procesin e komunikimit.



Profesor Bregu solli për audiencën problemet e hasura përgjatë një vëzhgimi të medies në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ky aktivitet është pjesë e synimeve që ka AZGj-ja në ngritjen profesionale të mëtejme të nëpunësve të saj.

19 prill 2022

AZGj-ja do ta ndihmojë Inspektoratin e Vetëqeverisjes Lokale, për të zbatuar gjuhën shqipe

Sot, në hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), drejtori Ylber Sela, e priti drejtorin e Inspektoratit të Vetëqeverisjes Lokale, Afrim Qokun, me të cilin diskutuan për bashkëpunim të ndërsjellë mes këtyre dy institucioneve.

Sela e falënderoi homologun e tij, Qoku, për interesimin e treguar ku i ofroi ndihmë dhe mbështetje për të filluar zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në atë institucion, me udhëzime konkrete se si të fillohet dhe si të drejtohet ky proces në fazën fillestare.



Nga ana tjetër, drejtori Qoku, shprehu gatishmëri dhe vullnet për të realizuar atë që është detyrim ligjor dhe pret përkrahje dhe bashkëpunim ndërmjet dy palëve për realizimin e mëtutjeshëm me sukses të këtij procesi.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se komunikimi ndërinstitucional duhet të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme.

21 prill 2022

AZGj-në e vizituan profesorët Hasan Jashari dhe Avzi Mustafa

Gjatë ditës së djeshme, Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së e vizituan dy profesorët e njohur, dr. Hasan Jashari dhe dr. Avzi Mustafa, të cilët i priti drejtori i saj prof. dr. Ylber Sela. Me këtë rast, drejtori Sela i njoftoi ata lidhur me angazhimin dhe punën që po bën AZGj-ja në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe, duke i ndihmuar institucionet me përkthime dhe lekturime të shkresave dhe të akteve të ndryshme. Gjatë bisedës ata u pajtuan që të bashkëpunojnë me AZGj-në në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe.

Në fund të këtij takimi, drejtori i AZGj-së, Ylber Sela ia dhuroi pllakën e "ABC-së" prof. dr. Avzi Mustafës, në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë për çështjen e emërtimeve të institucioneve.





26 prill 2022

Pjesëmarrje në Panairin mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor

Në kuadër të veprimtarive kushtuar 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela mori pjesë në Panairin mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, drejtori Sela mori pjesë në disa promovime librash, me ç'rast edhe i përshëndeti , duke bërë thirrje për bashkëpunim.

Më konkretisht, drejtori mori pjesë në promovimin e librit "Nën hijen e Çinarit", me autor Azis Pollozhani; në promovimin e botimit "Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe" të gjuhëtarit Gjovalin Shkurtaj; në promovimin e botimit "Aspekte të gjuhësisë së zbatuar" të gjuhëtarit Tomorr Plangarica, në promovimin e botimit "Monografia e Universitetit të Tetovës".

Kjo vizitë u shfrytëzua edhe për takime dhe njohje të reja të sferës së interesit të përbashkët.




50
22-24 PRILL 2022


MONOGRAFI
AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË

29 prill 2022

Mbaroi java e gjashtë dhe e shtatë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së gjashtë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, Analizë teksti, ligjëroi Ajtene Qamili, ndërkaq për temën e dytë, Përkthimi i teksteve të veçanta kulturore, ligjëroi Mustafa Ibraimi.

Edhe gjatë javës së shtatë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, , Përkthimi i teksteve të veçanta sociologjike, ligjëroi Ali Pajaziti, ndërkaq për temën e dytë, Përkthimi i teksteve për artet dhe shkencat humane, Dorian Koçi.



Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.

6 maj 2022

Fjalë rasti e drejtorit Ylber Sela në përurimin e librit "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit" të Fatmir Toçit

Të nderuar miq!

Duke marrë pjesë në këtë aktivitet promovues, në radhë të parë dua të theksoj se është një sfidë e veçantë dhe e përhershme të futesh në botën e arbëreshëve të Italisë, aq më tepër nëse këtë e bën në mënyrë hulumtuese për të nxjerrë në dritë realitetin e dhimbshëm të kësaj mërgate të moçme, e cila njëkohësisht mbeti edhe si krenari e veçantë kombëtare e shqiptarëve. Gjithsesi, në këtë rast duhet të themi troç se pa arbëreshët ne nuk do të ishim këta që jemi sot; popull me gjuhë, me histori, me kulturë, me tradita etj.

Pa dyshim, libri "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit" i autorit Fatmir Toçi na çon ose na e kujton se mërgata arbëreshe është zemra e shqiptarëve. Aty është shpërngulja dhe vuajtja, historia dhe qëndresa, identiteti dhe natyralizimi, ekzistenca dhe vizioni. Autori në fjalë shpalos realitetin e saj duke na ballafaquar me fenomenin arbëresh i cili ia doli të mbijetojë deri në ditët e sotme pa u zhdukur as në rrethanat globale. Faktet historike dhe të dhënat e shumta që i sjell në këtë libër, nxjerrin në sipërfaqe atë që e kishim humbur gjatë historisë, pra atdheun i cili mbeti në duart e pushtuesve. Megjithatë, nga ana tjetër mund të kuptohet se arbëreshët krijuan atdheun virtual duke e bartur atë brez pas brezi në kujtesën e tyre kolektive, duke e ruajtur dhe duke e kultivuar gjuhën e lashtë, si dhe duke e ndërtuar vizionin për rikrijimin e atdheut real.

Duke e lexuar këtë libër shumë të rëndësishëm historiko-kulturor, sigurisht ne kthehemi në thelbin e historisë dhe të realitetit tonë duke reflektuar më thellë për atë që kemi qenë, për atë që jemi dhe për atë që do të jemi. Mbi të gjitha, e arrijmë ta freskojmë kujtesën tonë kolektive e kombëtare, arrijmë të frymëzohemi për ta ruajtur edhe më tej qenien dhe identitetin tonë, veçanërisht gjuhën shqipe e cila po rrezikohet nga trysnia globale. Arbëreshet që i shpalos Fatmir Toçi në të gjitha dimensionet historike, kulturore, politike, shoqërore, ekzistenciale etj., na bëjnë të mendojmë dhe të bindemi se çdo vështirësi mund të tejkalohet dhe përsëri të mbetemi shqiptarë kudo që të jemi. Kjo do të thotë se proceset integruese që janë duke ndodhur, nuk nënkuptojnë edhe zhdukjen e asimilimin, por konkurrencën dhe komunikimin e barabartë midis popujve në kontinentin tonë.

Duke qenë në krye të një institucioni që kujdeset për gjuhën shqipe, siç është Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, aq më tepër ndihem i detyruar që të angazhohem në këtë aspekt. Prandaj, mund të them se libri i Fatmir Toçit është

ftesë për të gjithë ne, që ta mbrojmë qenien tonë, sidomos ta ruajmë gjuhën shqipe e cila është testament i përjetshëm.

Faleminderit për vëmendjen!





10 maj 2022

Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Më 10 maj, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ku u prit nga rektori i këtij universiteti, Skender Topi, zëvendësrektorja për kërkimin shkencor , Elvira Fetahu, zëvendësdekania e Fakultetit të Shkencave Humane, Aurela Basha, si dhe pedagogia e gjuhës, Teuta Toska.

Në këtë takim u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit të këtij universiteti me AZGj-në për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si seminare, trajnime, punëtori ku do të lëvroheshin tema gjuhësore. Gjithashtu u diskutua edhe për shkëmbim stafi e përvojash.



Ky takim u shfrytëzua edhe për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy drejtuesve të institucioneve të lartpërmendura, Skender Topi dhe Ylber Sela. Ata u dakorduan edhe në ndihmën e ndërsjellë për vendosjen e lidhjeve të komunikimit edhe me institucione të tjera me të cilat bashkëpunojnë.





12 maj 2022

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës ligjëroi profesoresha e gjuhës shqipe, Albulena Dehari

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) priti sot gjuhëtaren Albulena Dehari, ligjëruese në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Ajo pati rastin që të njihet më hollësisht me veprimtarinë e deritashme të AZGj-së, si dhe me planet për të ardhmen.

Me këtë rast, Dehari mbajti një ligjëratë para përkthyesve dhe lektorëve të Agjencisë me temë "Përshtatja e gjymtyrëve në fjali".

Në fund, drejtori Sela falënderoi ligjëruesen duke theksuar që AZGj-ja është e hapur për bashkëpunime të ndryshme të sferës përkatëse.



13 maj 2022

Mbaroi java e tetë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së tetë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, "Titrat", ligjëroi Olger Brame, ndërkaq për temën e dytë, "Çështje drejtshkrimore dhe të pastërtisë së gjuhës", ligjëroi Emil Lafe.

Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.






17 maj 2022

Pjesëmarrje në promovimin e librave në ITShKSh

Sot në hapësirat e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh) u promovua libri i Aleksandër Stipçeviqit "Kultura Tradicionale e Arbëneshëve të Zarës", ku të pranishëm ishin Prof.dr Skender Asani, drejtor i ITShKSh-së, Prof.dr. Luan Përzhita, drejtor i ASA-së Tiranë, Prof.dr. Hysen Matoshi, drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof. dr. Zeqirja Neziri, studiues nga Shkupi, si dhe të pranishëm të tjerë.



Fjalë rasti kishte edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në Maqedonin e Veriut (AZGj) Prof. dr. Ylber Sela.



19 maj 2022

Mbaroi edhe java e nëntë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Për të nëntën javë me radhë në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe i institucioneve publike.

Gjatë javës së nëntë temat që u zhvilluan ishin të ndryshme. Për temën e parë, "Përkthimi ligjor (juridik)" ligjëroi prof. Arta Selmani, ndërkaq për temën e dytë, "Përkthimi i korrespondencës ekonomike, afarizmit dhe kontratave", ligjëroi prof. Adnan Jashari.

Përkthyesit dhe lektorët edhe këtë javë kishin mundësinë të sqarojnë dilemat e tyre, që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së tyre të përditshme.





20 maj 2022

AZGJ-ja po e intensifikon bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës

Në takimin e sotëm në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës është diskutuar për ndihmën institucionale për përkthime dhe lekturime, me qëllim që terminologjia dhe leksiku të përdoren në mënyrë të drejtë.

AZGJ-ja mundëson që të përdoren burimet e saja për nevojat e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, që të sigurohet përdorimi i drejtë i gjuhës shqipe. Ajo është ndihmë e madhe, duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara për angazhimin e përkthyesve dhe lektorëve, në rrethanat aktuale.



Në takim morën pjesë edhe përfaqësues nga Fakulteti i Filologjisë i Universitetit Shtetëror të Tetovës Berton Sulejmani, profesori i gjuhës dhe i letërsisë shqipe nga Universiteti "Nënë Tereza" Mustafa Ibrahimi dhe profesori Ismet Osmani nga Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi".

AZGJ-ja mbetet e hapur për bashkëpunim në vazhdimësi me institucionet relevante, me qëllim që të arrihet cilësia në fushat që janë në kompetencë të saj.

25 maj 2022

Vizitë e suksesshme e drejtorit Sela në Grac të Austrisë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së kishte një vizitë pune në Grac të Austrisë.

Takimi i parë i punës ishte me drejtuesit e Qendrës Europiane për Gjuhët Moderne,e cila është pjesë e Këshillit të Europës. Takimi i punës u zhvillua me drejtoreshën Sara Breslin, si dhe me udhëheqësin e administratës së kësaj qendre, Majkëll Armstrong.

Drejtori Sela në hollësi e prezantoi historikun dhe veprimtarinë e Agjencisë, foli për mundësitë e bashkëpunimit, po ashtu theksoi nevojën për të mësuar nga përvojat e kësaj qendre dhe standardeve perëndimore. Drejtuesit e kësaj qendre të rëndësishme u shprehën të gatshëm të ofrojnë ndihmën e tyre dhe përvojën shumëvjeçare në fushën e shumëgjuhësisë. Gjatë takimit u fol edhe për modelet e suksesshme të shumëgjuhësisë në Europë, mundësitë e mbështetjes së përdorimit të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë, mënyrat më efikase për vetëdijesimin qytetar, si dhe për përparësitë që ofron shumëgjuhësia në përgjithësi, cilësi këto që janë tepër të dobishme për veprimtarinë e Agjencisë në shërbim të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Poashtu u diskutuan edhe mundësitë e projekteve hulumtuese, si dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo qendër u shpreh e gatshme të mbështesë Agjencinë në misionin e saj, duke filluar me këshillimin, si dhe trajnimin e bashkëpunëtorëve të saj.

Takimi i dytë i punës ishte me drejtoreshën e Qendrës për Gjuhë, Plurilingualizëm dhe Didaktikë në Universitetin e Gracit, Dr. Daniela Unger-Ullman. Drejtoresha e kësaj qendre bëri një prezantim të punës së vet tepër të suksesshme, përvojë nga e cila mund të mësojmë edhe ne.

Me atë u bisedua poashtu për mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional, sidomos në fushë të zhvillimit të politikave gjuhësore, dokumentimin e gjuhës, si dhe rritjes së standardit të mësimit dhe mësimdhënies së gjuhëve. Edhe drejtoresha Daniela Unger-Ullman u shpreh e gatshme ta kultivojë bashkëpunimin me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhëve, si dhe ta vizitojë atë në një të ardhme të afërt.

Shoqërues të drejtorit prof. dr. Ylber Sela në këtë udhëtim studimor ishin prof. dr. Izer Maksuti dhe Dardan Emini.


Council of Europe
Conseil de l'Europe





30 maj 2022

Mbaroi java e fundit e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka përfunduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së dhjetë, përkatësisht edhe të fundit, u realizua trajnimi në dy tema, ku ligjërues ishin Valter Memisha dhe Artur Lame me temë "Leksikologjia".

Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.





1 qërshor 2022

OSBE-ja trajnon përkthyesit dhe lektorët e AZGj-së, për përkthim simultan

Sot në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nisi trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), fryt i bashkëpunimit dypalësh ndërmjet OSBE-së dhe AZGj-së.

Me këtë rast, drejtori Ylber Sela falënderoi ambasadorin Clemens Koja për mbështetjen e OSBE-së në këtë drejtim. Ai theksoi që ky trajnim do t'u ndihmojë përkthyesve dhe lektorëve të AZGj-së në zhvillimin e tyre profesional në fushën e përkthimit simultan.

Nga ana tjetër, ambasadori Koja theksoi kënaqësinë për mbështetjen e deritashme nëpërmjet projekteve të përbashkëta të ngritjes së kapaciteteve të AZGj-së, ku përfshihet edhe trajnimi i filluar sot.

Njëmbëdhjetë përkthyesit dhe lektorët e AZGj-së do të trajnohen nga profesionistet e fushës së përkthimit simultan, Blerina Starova Zllatku dhe Lukrecija Malkoviq Atanasovska.

Ky trajnim mbështetet edhe nga kryetari i Kuvendit të RMV-së, Talat Xhaferi i cili ofroi kushtet e nevojshme teknike për këtë trajnim.




YUBER SELA
CLEMENS KOJA


msi



2 qërshor 2022

AZGj-ja mori pjesë në ekspozitën “Gjuha jonë” në Kumanovë

Pjesëmarrja e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së në aktivitetet që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, tanimë është bërë si një detyrë e përditshme. E tillë ishte edhe pjesëmarrja e saj në ekspozitën “Gjuha jonë”, e cila u hap në Shkollën Fillore Komunale “Jeronim de Rada” në Çerkez (Kumanovë), në suaza të patronatit të kësaj shkolle. Të pranishmit i përshëndeti drejtori i kësaj shkolle, zotëri Memet Bajrami. Ndërkaq, në emër të AZGj-së, i përshëndeti këshilltari shtetëror i përkthimit, Nebi Bilalli.



Po ashtu, para të pranishmëve foli edhe arsimtari Emrah Bilalli, duke i falënderuar të gjithë ata që kontribuan për këtë aktivitet kulturor.

Pastaj bashkërisht u shpall e hapur ekspozita në fjalë, e cila përmbante fotografi e dokumente për historikun e gjuhës shqipe, si dhe punime artistike të nxënësve të kësaj shkolle.

10 qërshor 2022

Fjalë rasti e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në shënimin e 10 qershorit, Ditës së Lidhjes së Prizrenit

Të dashur miq!

Sot, kur po e shënojmë Ditën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila u themelua më 1878, pra para 144 vjetësh, gjithsesi kemi një arsye të fuqishme për ta përkujtuar njërën nga motot kryesore të saj: "Pa gjuhë nuk ka komb", moto kjo e cila edhe në këto rrethana na kthen tek esenca dhe semantika e saj. Nga ky këndvështrim ndoshta mund të duket pak romantike, por realisht kjo paraqet thelbin dhe vizionin kryesor të shqiptarëve në këtë periudhë të ndryshimeve historike.

Pra, duhet ta përsërisim vazhdimisht se pa këtë gjuhë nuk ka asnjë perspektivë dhe as që mund ta paramendojmë ekzistencën tonë kombëtare. Siç e dimë, gjuha shqipe u kultivua nga rilindësit tanë dhe u ngrit në piedestalin më të lartë, prandaj këtë patjetër duhet ta bëjmë edhe sot pa asnjë ngurrim e pa asnjë dilemë.

Duke qenë në krye të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, mua më bie barra e përgjegjësisë që testamentin kombëtar të paraardhësve tanë për gjuhën shqipe ta bëj realitet edhe në këto hapësira ku jetojmë dhe veprojmë. Kjo nënkupton faktin se gjuhën shqipe duhet ta futim në përdorim zyrtar në institucionet shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, së pari duke i ndihmuar institucionet që ta zbatojnë atë me përpikëri, por nga ana tjetër edhe duke zhvilluar aktivitete që kanë të bëjnë me ruajtjen, kultivimin, afirmimin dhe trajtimin ligjor të saj. Natyrisht, pjesëmarrja jonë e drejtpërdrejtë në këto aktivitete kulturore e shkencore, por edhe bashkëpunimi me institucionet e tjera anekënd hapësirës shqiptare dhe më gjerë, aq më tepër na bën krenarë që jemi kontribues të denjë për gjuhën shqipe.

Me këtë rast, unë jam i prirur që në suaza të Lidhjes së Prizrenit ta shohim edhe veten tonë si një institucion që ka lindur si rezultat i vizionit të saj për gjuhën shqipe. Prandaj konsideroj se ne jemi trashëgimia dhe vazhdimësia historike dhe aktuale, jemi bartësit e frymës dhe të ideve të saj. Me anë të gjuhës shqipe ne do të vazhdojmë të ndihemi dhe ta quajmë veten shqiptarë deri në frymën e fundit. Në fakt, kjo është një arritje e madhe qytetëruese, kulturore dhe kombëtare për të cilën duhet të mburremi brez pas brezi. Dhe si e tillë kjo i bën krenarë shqiptarët, pa i dëmtuar të tjerët në asnjë mënyrë.

Në fund, dëshiroj të theksoj se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së do të mbetet besnike në këtë ecuri të pandalshme, gjithmonë duke menduar, folur e shkruar shqip. Ne çdo ditë japim mesazhin tonë: Jemi shqiptarë, prandaj duhet të flasim shqip kudo që të jemi, ndaj edhe në nivelet shtetërore. Në këtë mënyrë e

përmbushim amanetin historik të Lidhjes së Prizrenit duke mbetur përjetësisht shqiptarë.

Ju faleminderit!





13 qërshor 2022

Vizitë pune në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, i kryesuar nga drejtori Ylber Sela, realizoi vizitë pune në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u takua me sekretarin e përgjithshëm të kësaj organizate, Sait Saiti.

Me këtë rast u rikonfirmua interesimi i Agjencisë për bashkëpunim me Kryqin e Kuq, si organizatë e pavarur, joqeveritare, vullnetare humanitare, që kryen veprimtari me interes publik në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, duke u bazuar në parimet e humanizmit dhe solidaritetit.



Drejtori Sela e njoftoi bashkëbiseduesin për punën e deritanishme dhe aktivitetet e planifikuara të Agjencisë, në interes të përdorimit të drejtë dhe të përpiktë të gjuhës shqipe, në nivel institucional dhe lokal, në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Nga ana tjetër, sekretari i përgjithshëm Saiti e njohu bashkëbiseduesin me mënyrën e funksionimit të organizatës dhe përdorimin e gjuhës shqipe në punën e saj, e cila është model i mirë për funksionimin e një organizate joqeveritare, si dhe falënderoi përfaqësuesit e Agjencisë për vizitën e tyre duke shprehur gatishmëri për bashkëpunim të nismave të përbashkëta.

13 qërshor 2022

Bashkëpunim i vendosur me Drejtorinë e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore

Në kuadër të agjendës intensive të punës së sotme, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, Ylber Sela, ka vizituar Drejtorinë e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, ku realizoi takim pune me drejtorin Arian Asllanaj, me të cilin biseduan për bashkëpunim të ndërsjellë të këtyre dy institucioneve.



Drejtori Sela e falënderoi kolegun për mikpritjen dhe njëkohësisht i ofroi mbështetjen e tij me udhëzime të përpikëta për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion, si organ në kuadër të Ministrisë së Kulturës.

Nga ana tjetër, drejtori Asllanaj, shprehu vullnetin dhe gatishmërinë për ta realizuar detyrimin ligjor, duke theksuar se pret ndihmë dhe bashkëpunim mes dy palëve për realizim me sukses të këtij procesi.

16 qërshor 2022

Drejtori i AZGJ-së mori pjesë në homazhin për Omer Kaleshin

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela mori pjesë në homazhin për nder të piktorit me famë botërore, Omer Kaleshi, të cilin e organizoi Galeria Nacionale "Hamami Çift" në bashkëpunim me Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe anëtarët e familjes së tij.



Maestro i madh Kaleshi kishte një shpirt kozmopolit. Në punën e tij krijuese gjatë tërë jetës u qëndroi besnik rrënjëve të tij, me fokusin kryesor në fytyrën e njeriut, duke theksuar kokën si simbol të shpirtit të tij.

23 qërshor 2022

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së Ylber Sela në promovimin e fjalorit bashkëbisedues katërgjuhësh

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të jem pjesë e promovimit të sotëm zyrtar të një tjetër vargu projektesh të suksesshme të Qendrës së Dialogut Nansen – Fjalor bashkëbisedues katërgjuhësh në maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht, dhe prezantimi i platformës shumëgjuhëshe FRAZA.

Qendra e Dialogut Nansen në mënyrën më të mirë të mundshme përsëri e dëshmon bashkëpunimin e suksesshëm shumëvjeçar me Zyrën e Komisarit të Lartë të Pakicave Kombëtare të OSBE-së, duke realizuar një tjetër projekt të dobishëm për shoqërinë, qëllimi kryesor i të cilit është mirëkuptimi dhe ndërveprimi më i madh gjuhësor midis anëtarëve të bashkësive të ndryshme që jetojnë në vendin tonë me shoqëri multietnike, duke afirmuar vlerat e shumëgjuhësisë, të interaktivitetit dhe të origjinalitetit.



Fjalori bashkëbisedues katërgjuhësh i mundësuar nëpërmjet platformës së veçantë audiovizuale shumëgjuhëshe, paraqet edhe një hap më afër mirëkuptimit dhe kohezionit ndëretnik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Struktura e kujdesshme dhe vizualizimi i shkëlqyer i vetë fjalorit bashkëbisedues, paraqet bazë të mirë të mësimit më të lehtë të gjuhëve të cilat janë në përpunim brenda tij. Pa dyshim, mjetet e tilla shumëgjuhësore kanë arsyetim më të gjerë shoqëror, duke kontribuar në forcimin e parimeve të

bashkësive, respektit dhe tolerancës ndëretnike si vlera të rëndësishme universale njerëzore.

Dëshiroj t'i përgëzoj të gjitha palët e përfshira në realizimin e projektit, autorëve të fjalorit bashkëbisedues, Komisarit të Lartë të Pakicave Kombëtare të OSBE-së z. Abdrakhmanovin, për mbështetjen e tij personale në iniciativa të tilla të dobishme, si dhe t'i falënderohem edhe organizatorit të kësaj ngjarjeje - Qendrës së Dialogut Nansen dhe mikut tim të nderuar Veton Zekollit për ftesën që të jem pjesë e ngjarjes së sotme, dhe për t'ju uruar edhe shumë projekte të suksesshme në të ardhmen.

Shpresoj dhe besoj se ky fjalor bashkëbisedues do të zgjojë interes të gjerë dhe do të ketë përgjigje pozitive nga lexuesit.

Faleminderit!



28 qërshor 2022

Takim me kryetaren e Këshillit Inspektues

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, realizoi takim me kryetaren e Këshillit Inspektues, Daniella Rendevska.

Në takim u fol rreth sfidës me të cilën ballafaqohet Këshilli Inspektues në lidhje me zbatimin e gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së në softuerin e dhënies së provimit për marrjen e licencës së inspektorit.



Kryetarja e Këshillit shpjegoi se tanimë punohet në ndryshimet e nevojshme. Materiali që është lëndë e trajnimit të inspektorëve, tanimë është në të dyja gjuhët zyrtare dhe realizohet në tërësi. Licencat që ua lëshojnë inspektorëve tanimë janë të përpunuara në të dyja gjuhët zyrtare. Gjithashtu, punojnë edhe në tejkalimin e problemit me dhënien e provimit në dy gjuhë.

Drejtori i Agjencisë i ofroi kapacitetet e tij, me qëllim që të ndihmojë gjatë lekturimit të materialeve të provimit.

28 qërshor 2022

Vendoset bashkëpunimi me Inspektoratin Administrativ Shtetëror

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela vizitoi Inspektoratin Administrativ Shtetëror, ku u realizua takimi me drejtoreshën Keti Vasilevska.

Vizita u iniciua nga drejtori Sela për të kuptuar gjendjen e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e Inspektoratit, si dhe vendosjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve, për çështjet që lidhen me përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurat administrative.



Për shkak të mbarëvajtjes pa pengesa të proceseve të punës në Inspektorat, drejtori Sela ofroi mbështetje të plotë në pjesën e ndihmës profesionale për përkthim dhe lekturim të formularëve zyrtarë, ndërkaq dorëzoi një pako botimesh të AZGj-së. Nga ana tjetër, drejtoresha Vasilevska, theksoi se nisma e vizitës në Inspektorat është e mirëseardhur dhe ekziston vullneti i zbatimit të detyrimeve zyrtare, si dhe tejkalimi i sfidave aktuale.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit rikonfirmuan angazhimin për vazhdimin e dialogut dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional.

12 korrik 2022

U ndahen certifikatat 12 pjesëmarrësve të cilët me sukses e mbaruan trajnimin për interpretim simultan

Sot, në hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, drejtori Ylber Sela, i ndau certifikatat për trajnimin e kryer për interpretim simultan, projekt i cili u realizua gjatë muajit qershor këtë vit, në hapësirat e Institutit Parlamentar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si rezultat i bashkëpunimit dypalësh ndërmjet AZGj-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup.



Në këtë rast drejtori Sela, jua ndau certifikatat gjithsej 12 (dymbëdhjetë) pjesëmarrësve, duke i përgëzuar për profesionalizmin e treguar, me besimin se ky trajnim do t'ju ndihmojë në zhvillimin e tyre profesional në fushën e interpretimit simultan.

Gjithashtu, drejtori Sela, e falënderoi edhe Mision e OSBE-së në Shkup dhe ambasadorin Klemens Koja, për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, ligjëruesve zonjën Blerina Starova Zllatku dhe zonjën Llukrecija Mallkoviq Atanasovska, si dhe zotëri Talat Xhaferin, kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për mbështetjen në sigurimin e hapësirave të nevojshme dhe shërbimeve teknike për realizimin e projektit.

13 korrik 2022

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup vizitoi AZGj-në

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës së RMV-së në Shkup qëndroi për vizitë ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, shkëlqesia e tij, Florian Qehaja, ku u prit nga drejtori Ylber Sela.

Me këtë rast, drejtori Sela e njoftoi ambasadorin Qehaja, për aktivitetet e deritashme të kësaj agjencie, duke theksuar bashkëpunimet e shumta me institucione të ndryshme të rëndësishme në vend.

Ambasadori Qehaja shprehu falënderim për pritjen dhe shprehu gatishmëri për bashkëpunim në të ardhmen.





19 korrik 2022

Bashkëpunim ndërinstitucional me BPRMV-në

Një ekip i Agjencisë së Zbatimit të gjuhës të RMV-së (AZGj) i udhëhequr nga drejtori, Ylber Sela, vizitoi Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV), i cili u prit nga ekipi i kësaj banke, i udhëhequr nga guvernatorja Anita Angelovska-Bezhoska.

Fillimisht, ekipi i AZGJ-së vizitoi Muzeun e BPRMV-së, me ç'rast u njoh me artefaktet e ndryshme të cilat janë përdorur në kartëmonedhën vendore – denarin.

Më pas, të dy ekipet mbajtën një takim të përbashkët, ndërkaq temë diskutimi ishte zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Guvernatorja Bezhoska njoftoi për vështirësitë që hasin gjatë përkthimit dhe redaktimit të materialeve të ndryshme të cilat i përpilon BPRMV-ja, por që mundohen të përmbushin çdo detyrim ligjor.

Nga ana tjetër, drejtori Sela ofroi mbështetjen e AZGj-së, si një detyrim ligjor që vazhdon të ofrohet për secilin institucion që ka nevojë.

Palët u dakorduan që të vazhdojë fryma e deritashme e bashkëpunimit ndërinstitucional.

9 gusht 2022

Vizitë pune në IN "Muzeu Memorial i Nënë Terezës" – Shkup

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela vizitoi Institucionin Nacional "Muzeu Memorial i Nënë Terezës" – Shkup, ku u takua me z. Naser Curi, drejtor i institucionit.

Sela e falënderoi kolegun e tij Curi për mikpritjen dhe i ofroi mbështetje rreth zbatimit të detyrimeve të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion, duke i dhënë botime të AZGj-së.

Drejtori Curi e njoftoi bashkëbiseduesin e tij me aktivitetet e realizuara dhe të planifikuara të institucionit.



Gjithashtu theksoi edhe gatishmërinë e tij për bashkëpunim me AZGj-në në temat që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës shqipe në këtë institucion kulturor të një rëndësie të veçantë, veprimtaria e të cilit është e lidhur me mbrojtjen, hulumtimin, mirëmbajtjen, përdorimin dhe prezantimin e lëndëve të muzeut të lidhura me jetën, veprën dhe misionin e Nënë Terezës.

10 gusht 2022

Veprimtari Vaxhid Sejdiu vizitoi AZGj-në



Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj) qëndroi Vaxhid Sejdiu, veprimtar i arsimit shqip në Zvicër, i cili u prit nga drejtori Ylber Sela.

Si kryetar i Këshillit Koordinues të Arsimtarëve në Diasporë dhe koordinator i "Shkollës shqipe" në Zvicër ai është njëri ndër aktivistët më të mëdhenj të hapjes së shkollave shqipe në Zvicër.

Duke e vlerësuar lart punën e tij arsimore e kombëtare, Sejdiu e Sela biseduan për kontributin që jep mërgata jonë edhe për proceset dhe zhvillimet për avancimin dhe barazinë politike, ekonomike, kulturore etj., të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Drejtori Sela e njoftoi edhe rreth themelimit, punës, dhe aktiviteteve të Agjencisë, për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe për sfidat e zbatueshmërisë së dygjuhësisë në shtet.

12 gusht 2022

Përfaqësues të shoqatave shqiptare në Itali vizituan AZGj-në

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj) qëndruan Nehat Marku, sekretar i Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Itali dhe Abdulla Salihi, kryetar i shoqatës "Rilindja" në L'Aquila të Italisë.

Ata u pritën nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili i përgëzoi për kultivimin dhe ruajtjen e gjuhës, kulturës e të identitetit kombëtar.

Me këtë rast, Sela i informoi për punën dhe kompetencat e AZGj-së, ndërkaq u dhuroi botimet e Agjencisë.







19 gusht 2022

Takim dypalësh ndërmjet AZGj-së dhe shkollës së mesme "Zdravko Cvetkovski"

Një ekip i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, i shoqëruar nga drejtori Ylber Sela, realizuan një vizitë në shkollën e mesme "Zdravko Cvetkovski" të Shkupit.

Ata u pritën nga drejtuesit e kësaj shkolle, drejtoresha Jasmina Bërseva dhe ndihmësdrejtori, Tesnim Etemi.




Me këtë rast, drejtuesit e shkollës u njoftuan konkretisht për funksionin, punën e deritanishme, aktivitetet dhe planet për të ardhmen të AZGj-së.

22 gusht 2022

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj), Ylber Sela priti në takim Liridon Baftijin, drejtor i Qendrës së Punëve Sociale të Shkupit (QPS).

Me këtë rast drejtuesit e të dy institucioneve përfunduan bashkëpunimin dypalësh që kishte të bëjë me përkthimin dhe redaktimin e formularëve të ndryshëm që janë në shfrytëzim në QPS.



Qytetarët shqiptarë të cilët i drejtohen QPS-së, do të mund që kërkesat e tyre t'i dorëzojnë edhe në gjuhën shqipe.

29 gusht 2022

AZGj zgjeron bashkëpunimin ndërinstitucional

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) qëndroi Mexhit Emurli, zëvendësdrejtor i Komisionit të Marrëdhënieve Ndërfetare dhe i Grupeve Religjioze (KMNGR), i cili u prit nga drejtori i AZGj-së, Ylber Sela.

Me këtë rast, bashkëbiseduesit diskutuan për vendosjen e bashkëpunimit ndërinstitucional që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në komisionin e lartpërmendur.



AZGj-ja është e gatshme që të mbështesë zbatimin e ligjit në fjalë në çdo institucion që përballet me vështirësi në këtë drejtim.

2 shtator 2022

Ndahen certifikatat për gjeneratën e dytë të pjesëmarrësve në trajnim për përkthyes dhe lektorë

Në amfiteatrin e Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup, sot u mbajt ceremonia përfundimtare e ndarjes së certifikatave për gjeneratën e dytë të pjesëmarrësve, të cilët morën pjesë në trajnimin për përkthim dhe lektorim nga maqedonishtja në shqip dhe nga shqip në maqedonisht.

Në këtë aktivitet foli drejtori i AZGj-së, Ylber Sela dhe ministri i Shoqërisë Informative dhe i Administratës, Admirim Aliti. Të ftuar në këtë aktivitet ishin anëtarë të pushtetit ekzekutiv, përfaqësues të trupit diplomatik, duke përfshirë shefin e misionit të BE-së, ambasadorin David Geer, zëvendësshefi i misionit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Otto Graf, drejtues të institucioneve publike, anëtarë të komunitetit akademik, përfaqësues të sektorit civil dhe medias.

Në trajnim u përfshinë 72 nëpunës nga 43 institucione publike që kryejnë punë të përkthimit dhe lektorimit në gjuhët zyrtare. Pjesën mësimore të trajnimit e realizuan ligjërues, profesorë dhe gjuhëtarë eminentë nga vendi ynë, nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës, të cilët hartuan ligjërata të përshtatshme nga fusha të veçanta gjuhësore. Gjithashtu, mjet i dobishëm në realizimin e trajnimit ishte Manuali i trajnimit, shtypja e të cilit është mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup.






EUROPAE ORIENTALIS



15 shtator 2022

Vizitë e realizuar pune në IN Opera dhe Baleti Nacional, Shkup

Me iniciativë të drejtorit të AZGj-së, Ylber Sela, u realizua vizitë në Institucionin Nacional Opera dhe Baleti Nacional, Shkup, ku u zhvillua takim pune me z. Vaso Ristov, drejtor i institucionit.

Të dy bashkëbiseduesit diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me zbatimin e detyrimeve të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e këtij institucioni të rëndësishëm nacional në fushën e kulturës.



Drejtori Ristov, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me AZGj-në, duke theksuar se përkundër kufizimeve të caktuara kadrovike dhe buxhetore që ekzistojnë, do të angazhohet për zbatimin e përpiktë të ligjit, për shkak të plotësimit të nevojave të qytetarëve si vizitorë në Operën dhe Baletin Nacional të Shkupit.

23 shtator 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare që u mbajt në MPJ

Në amfiteatrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme u mbajt konferenca e 17-të vjetore ndërkombëtare, e bashkëorganizuar nga Kolegji Amerikan i Shkupit dhe UNHCR në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me temën PRIORITETET E RIDEFINUARA: REALITETET E REJA PAS KRIZËS UKRAINASE (PRIORITIES REDEFINED: NEW REALITIES AFTER THE UKRAINIAN CRISIS).

Në këtë konferencë mori pjesë dhe mbajti fjalim në njërin nga sesionet e saj edhe dr. Ylber Sela, në cilësinë e studiuesit dhe të bashkautorit të një punimi hulumtues, të përgatitur në bashkëpunim me dr. Marina Andevën nga Universiteti Kolegji Amerikan i Shkupit, me titullin e punës "Gjuhët dhe identitetet në Maqedoninë e Veriut: sfidat ligjore dhe politike në formimin e shtetit" (”Languages and Identities in North Macedonia: Legal and Political Challenges to State Formation“).



26 shtator 2022

U shënua Dita Europiane e Gjuhëve, me një panel diskutim

Me rastin e 26 Shtatorit, Ditës Europiane të Gjuhëve, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) organizoi debat në Europe House.

Pjesëmarrës dhe folës në këtë aktivitet ishin ambasadori i BE-së në Shkup, David Geer, ambasadorja e Konfederatës së Zvicrës në Shkup, Veronik Ulman Marti, ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Jeton Shaqiri dhe Marina Andeva, profesoreshë në Universitetin Amerikan Kolexh në Shkup.

Të pranishmit diskutuan rreth sfidave të shumëgjuhësisë në kontekstin vendor, zviceran e atë europian. Nuk munguan as pyetjet nga publiku drejtuar panelistëve pjesëmarrës.





26 shtator 2022

Fjalimi i drejtorit të AZGj-ës, dr. Ylber Sela, në panelin e diskutimit: "Europa e qytetarëve të barabartë me indentitetin e tyre gjuhësor – Vështrim drejt të ardhmes"

I nderuar ministër i Arsimit dhe i Shkencës, z. Shaqiri!

i nderuar ambasador dhe shef i Delegacionit të Bashkimit Europian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Gir!

i nderuar ambasador i Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut, znj. Ulman Marti!

e nderuara profesoreshë Andeva!

i nderuar drejtor i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve, z. Iseni!

të nderuara zonja dhe zotërinj!

të nderuar të pranishëm!

Është nder dhe kënaqësi e madhe që përzemërsisht e pranuat ftesën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, për të festuar së bashku 26 shtatorin, ditën në të cilën Europa feston shumëgjuhësinë dhe shumëllojshmërinë gjuhësore që nga viti 2001.

Më lejoni, në këtë rast, të falënderoj Delegacionin e Bashkimit Europian për mundësinë e organizimit të manifestimit të sotëm në hapësirat e EUROPE HOUSE në Shkup.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, e shënon këtë ditë simbolike për të katërtin vit me radhë, duke iu bashkuar një numri të madh të subjekteve nga sektori publik dhe shoqëria civile në kontinentin europian, të cilët me aktivitetet e tyre e shënojnë Ditën Europiane të Gjuhëve.

Në vitin në të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut filloi fazën hyrëse të procesit të anëtarësimit drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Europian, përmes fillimit të procesit të skriningut, përsëri e theksojmë rëndësinë e politikave që synojnë krijimin e shoqërive civile të qëndrueshme me qytetarë të barabartë me identitetin e tyre gjuhësor.

Angazhimi për prosperimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si anëtare e ardhshme e plotë e Bashkimit Europian, nuk mund të imagjinohet pa respektimin e frymës europiane të bashkimit dhe bashkëpunimit, bashkëjetesës paqësore dhe bashkëjetesës ndëretnike, respektimit të vlerave njerëzore, dinjitetit, barazisë dhe solidariteti, ku individi vendoset në fokusin e politikave, duke respektuar autenticitetin e tij kulturor, fetar dhe gjuhësor. Në fakt, respektimi i kulturës, shumëllojshmërisë fetare dhe gjuhësore është pjesë përbërëse të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, a ndalimi i çdo forme të diskriminimit gjuhësor është pjesë përbërëse edhe e Deklaratës

Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

Gjuha pasqyron jo vetëm identitetin personal të individit, por shërben edhe si mjet komunikimi dhe ndërveprimi në bashkësinë shoqërore. Gjuha është lloj dritareje drejt botës, çelës që hap dyert, urë për t'u lidhur me personin tjetër pranë nesh.

Pasuria e gjuhëve të ndryshme është vlerë me të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut, si pjesë e kontinentit europian, duhet të krenohet dhe ta vlerësojë vazhdimisht. Çdo përpjekje për të rrezikuar dhe sfiduar këtë vlerë do të ishte në kundërshtim me vlerat demokratike europiane të respektimit dhe nderimit të shumëllojshmërisë gjuhësore. Në vend të ndarjeve gjuhësore dhe kthimit në të kaluarën, le të jetë dialogu dhe toleranca gjuhësore kontributi ynë në një të ardhme të begatë.

Më lejoni, në fund të fjalës sime, të falënderoj edhe një herë të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre në panelin e sotëm, dhe të falënderoj të gjithë të pranishmit për kohën dhe interesimin e dhënë për këtë ngjarje.



28 shtator 2022

Vepra "Dardanët", me autor Luan Përzhitën, u promovua në Shkup

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Akademia e Studimeve Albanologjike dhe Institucioni Nacional "Shtëpia Përkujtimore Nënë Tereza" promovuan sot veprën arkeologjike "Dardanët", të autorit Luan Përzhita.

Me këtë rast, promovimin e përshëndeti drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, i cili përgëzoi autorin Përzhita për këtë punë kolosale.

Për veprën "Dardanët" diskutuan profesorët Arben Ajdari, Kemal Luci, Milot Berisha, Mexhait Pollozhani.

Këtë aktivitet e përshëndeti edhe vet autori, Luan Përzhita, i cili në fund nënshkroi disa nga veprat e dhuruara për të pranishmit.





29 shtator 2022

Drejtori Ylber Sela mori pjesë në Seminarin e 16-të të Albanologjisë në Universitetin e Tetovës

Në Universitetin e Tetovës (UT) u mbajt seminari i 16-të i Albanologjisë, me ç'rast morën pjesë një numër i madh gjuhëtarësh.

.



Temë e sivjetme e seminarit ishte "Kultura dhe Globalizimi".

Seminarin e ndoqi nga afër edhe drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, i cili e vlerësoi lartë këtë aktivitet.



29 shtator 2022

Filloi Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së organizon konferencën shkencore ndërkombëtare dyditore me temën "Çështje të standardizimit të toponimisë në RMV".



Konferenca filloi sot pasdite në amfiteatrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, me pjesëmarrës të disa nga institucionet shkencore dhe arsimore nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga rajoni.

Konferencën shkencore e hapi drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili ndër të tjera theksoi se tema e kësaj konference u zgjodh me kujdes sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe i referohet çështjeve të standardizimit të toponimisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Toponimia paraqet padyshim një degë të rëndësishme shkencore sepse na jep mundësinë t'i referohemi historisë dhe identitetit kulturor të vendeve të caktuara gjeografike. Prandaj, nevoja për zbatimin adekuat të toponimisë është më se e dukshme", tha ai. Standardizimi i toponimisë është proces i rëndësishëm, vazhdoi drejtori i

AZGJ-së, duke theksuar se bashkëpunimi ndërdisiplinor është çelësi i suksesit të tij. “Bashkëpunimi i vendosur i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së me institucionet shkencore dhe ato arsimore brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht me ato nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, mundëson diskutimin e dilemave dhe çështjeve që dalin nga procesi i standardizimit të toponimeve, me qëllim që procesi të jetë funksional, të zbatohet saktë nga pikëpamja gjuhësore dhe të zbatohet me sukses në tërësi”, tha në prezantimin e tij drejtori Ylber Sela.

Pas drejtorit Sela, fjalimet e tyre i mbajtën edhe Luan Përzhita, Rektor i Akademisë së Studimeve të Albanologjisë nga Tirana, Republika e Shqipërisë; Skender Asani, drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve; profesori në pension Agim Vinca dhe profesori Isak Shema nga Republika e Kosovës.

Në konferencë u prezantuan edhe punimet me temën “Terminologjia dhe roli i saj në njohjen e gjuhës profesionale”, për të cilën kanë folur Izer Maksuti dhe Xhafer Beqiraj nga Universiteti “Ukshin Hoti” nga Prizreni, Republika e Kosovës, si dhe Zeqirja Ibrahimi nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve.

Në fund të ditës së parë të Konferencës, u mbajt edhe paneli ku bënë prezantimet e tyre hulumtuesit shkencorë nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës.

Begzad Baliu nga Universiteti i Prishtinës trajtoi temën “Standardet politike të toponimisë në Ballkanin Perëndimor”.

Leonora Hisolli nga Universiteti "Fan S. Noli" nga Korça, Republika e Shqipërisë, pati prezantimin e saj me temën "Kontributi i studimeve të Qemal Muratit në standardizimin e toponimisë në RMV", dhe Irena Nikaj nga i njëjti universitet trajtoi temën "Vlera historike dhe kulturore e emrave të vendeve si trashëgimi kulturore”.

Berton Sulejmani nga Universiteti i Tetovës iu drejtua të pranishmëve me prezantimin me temën “Toponimia e gjuhës shqipe në komunën e Butelit”, ndërsa Izer Maksuti nga Universiteti “Ukshin Hoti” nga Prizreni, Republika e Kosovës mbajti një prezantim me temën “Toponimia nga këndvështrimi i politikës gjuhësore në shembullin e Tirolit të Jugut dhe Austrisë”.

Konferenca vazhdon edhe ditën e nesërme.







29 shtator 2022

U promovua përmbledhja e punimeve shkencore "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale"

Në suaza të aktiviteteve për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së promovoi edhe përmbledhjen e punimeve shkencore "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale". Përmbledhja në fjalë përfshin punimet e konferencës shkencore e cila u mbajt vitin e kaluar për shënimin e kësaj dite ndërkombëtare.

Fjalë rasti për këtë botim mbajtën prof. dr. Izer Maksuti, ligjërues në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. dr. Xhafer Beqira, ligjërues në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe dr. Zeqirja Ibrahimi, punonjës shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Referuesit në fjalë vunë në dukje vlerat e veçanta të këtij libri lidhur me çështjen e terminologjisë profesionale.









30 shtator 2022

Dita Ndërkombëtare e Përkthimit - 30 Shtator e shënuar nga AZGJ-ja me një tjetër konferencë të suksesshme shkencore

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt dita e dytë dhe e fundit e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të cilën e ka organizuar Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së me temën "Çështjet e standardizimit të toponimisë në RMV", me rastin e 30 shtatorit – Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit.

Në fillim mbajtën fjalimet e tyre Liljana Pandeva nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, si dhe Berton Sulejmani, dekan i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tetovës.

Në kuadër të ditës së fundit të Konferencës, u mbajt paneli i moderuar nga Remzie Shahini Hoxhaj nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës, në të cilin i paraqitën prezantimet e tyre disa punonjës shkencorë nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës.

Ajten Hajdari Qamili nga Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" nga Shkupi trajtoi temën "Toponimet me prapashtesat -ci, -vci dhe -ishte në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

Nail Draga, punonjës shkencor nga Mali i Zi mbajti prezantimin e tij me temën "Toponimet, dëshmi e vlerave etnokulturore të çdo mjedisi".

Meleq Shopi nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" nga Elbasani, Republika e Shqipërisë pati një prezantim me temën: "Toponimia dygjuhëshe dhe disa probleme në shkrimin e toponimeve në Maqedoninë e Veriut".

Olger Brame nga Universiteti "Fan S. Noli" nga Korça, Republika e Shqipërisë mbajti prezantimin e tij me temën "Etimologjia e toponimeve në zonën e Korçës në Fjalorin Etimologjik të Kolec Topalit", dhe Albina Pajo nga po i njëjti universitet foli për temën "Struktura fjalëformuese e toponimeve në veprën e Mitrush Kutelit".

Bahtiar Kryeziu nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës, trajtoi temën "Anamorava sipas emrave të vjetër shqiptarë dhe mitifikimi i tyre".

Rakela Luniku nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" nga Elbasani, Republika e Shqipërisë trajtoi temën "Karakteristikat e strukturave leksiko-gramatikore dhe fjalëformimi i toponimeve në Maqedoninë e Veriut".

Manjola Zaçellari nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" nga Durrësi, Republika e Shqipërisë dhe Lirim Shabani nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, iu drejtuan të pranishmëve me prezantimet e tyre me temën

"Problemet në emërtimin e rrugëve në shqip dhe standardizimi i tyre në Maqedoninë e Veriut".

Fjalim të shkurtër para të pranishmëve mbajti edhe Begzad Baliu nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës, për çështjet që kanë të bëjnë me standardizimin e toponimeve.

Pas përfundimit të panelit, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, Ylber Sela, e mbylli konferencën duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë në mbajtjen me sukses të konferencës, duke siguruar se tubime të tilla shkencore janë jashtëzakonisht të rëndësishme sepse i referohen çështjeve të rëndësishme që janë lëndë debati në komunitetin shkencor, si dhe që Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së do të vazhdojë të organizojë ngjarje të ngjashme në të ardhmen për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit.











6 tetor 2022

Drejtori Sela në Panairin e Botimeve Albanologjike

Në kuadër të bashkëpunimit Tiranë-Prishtinë-Shkup, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, më 4-5 tetor 2022, u mbajt Panairi i Botimeve Albanologjike.

Me këtë rast, u promovuan disa libra të sferës së albanologjisë, të autorëve të ndryshëm.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj), Ylber Sela, i cili shfrytëzoi rastin që të dhurojë disa kopje të botimit më të ri të AZGj-së, "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale".





12 tetor 2022

U shënua 50-vjetori i themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Me ftesë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (AShSh), drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj), Ylber Sela qëndroi në Tiranë për të marrë pjesë në aktivitetet e shënimit të 50-vjetorit të Akademisë.

Aktivitetet filluan me vendosjen e buqetave me lule te bustet e akademikëve themelues, Aleks Buda dhe Eqrem Çabej.





Më pastaj, drejtori Sela ndoqi konferencën jubilare kushtuar 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave në sallën plenare të Kuvendit të Shqipërisë.



Gjatë shënimit të këtij 50-vjetori, drejtori Sela u prit edhe nga presidenti, Bajram Begaj, në mjediset e institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.



.

13 tetor 2022

Bashkëpunim i lidhur me QSHAK "Boro Petrushevski"

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, e vizitoi Qendrën Shkollore të Autokomunikacionit "Boro Petrushevski" - Shkup, ku u takua me drejtorin e Qendrës, z. Goranço Nikollovski dhe ndihmësdrejtorin e qendrës z. Zekirija Zekiri.

Vizita është pjesë e ciklit të rregullt të vizitave të institucioneve, në të cilën u diskutua për shkallën e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e Qendrës si institucion publik në Qytetin e Shkupit, e cila kryen veprimtari edukativo-arsimore primare në fushën e komunikacionit, makinerisë dhe autoteknikës, nëpërmjet shkollimit të rregullt dhe me korrespondencë në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe, portofolio i së cilës përfshin edhe veprimtari të tjera plotësuese.



Krahas aktiviteteve të ndërmarra, të dyja palët konstatuan se janë të hapura dhe të përgatitura për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë në drejtimin e ngritjes së shkallës së harmonizimit me detyrimet ligjore dhe zbatimin e gjuhëve zyrtare në punën e Qendrës.

13 tetor 2022

Deputetja Ermina Lekaj Përlaskaj vizitoi AZGj-në

Deputetja e kuvendit të Kroacisë, Ermina Lekaj Përlaskaj qëndroi sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj), ku u prit nga drejtori Ylber Sela.

Gjatë kësaj vizite, deputetja Përlaskaj u interesua për rolin, veprimtarinë dhe planet e AZGj-së për të ardhmen.



Drejtori Sela e falënderoi për interesimin e treguar, duke pasqyruar veprimtarinë e AZGj-së, nga fillimi e deri më sot.

Me këtë rast, palët u dakorduan për një bashkëpunim të mundshëm në të ardhmen.

19 tetor 2022

Drejtuesit e Sh.F.K "Kongresi i Manastirit" vizituan AZGj-në

Drejtori dhe sekretari i shkollës fillore komunale "Kongresi i Manastirit" të fshatit Llopat, Kumanovë, përkatësisht Shpend Muhtari dhe Shukri Bekiri vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj).

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja dhe informimi më i saktë rreth punës dhe funksionit që ka AZGj-ja si një institucion i themeluar pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Drejtori Sela ofroj sqarimet e nevojshme për miqtë, duke u dhënë edhe botimet e AZGj-së.

21 tetor 2022

Sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, në organizim të këtij instituti dhe të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, si dhe në praninë e shumë gjuhëtarëve dhe intelektualëve të tjerë, u promovua "Fjalori serbisht-shqip" i shkrimtarit e publicistit, tashmë edhe leksikografit, Rexhep Zllatku.


Në fillim të pranishmit i përshëndeti dhe u uroi mirëseardhje drejtori i Institutit, dr. Skender Asani. Ai e theksoi rëndësinë e kësaj vepre dhe nderimin që ia bën gjuhësisë shqiptare në këtë 50-vjetor të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Pas tij, fjali rasti pati edhe dr. Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Ai foli për rëndësinë që e ka ky fjalor edhe për punën që bën sot Agjencia. Për vlerën shkencore të fjalorit foli gjuhëtari prof. Qemal Murati, i cili vuri theksin në vlerën leksikografike të kësaj vepre për gjuhësinë shqiptare.

Gjuhëtari Zeqirija Ibrahimi foli për bashkëpunimin që ka pasur me autorin, Rexhep Zllatku, për redaktimin dhe botimin e fjalorit.

Në fund, të pranishmit i përshëndeti edhe autori i veprës, Rexhep Zllatku, i cili i falënderoi të pranishmit, organizatorët e promovimit, prof. Qemal Muratin dhe prof. Zeqirija Ibrahimin, ndërkaq foli edhe për betejën shkencore dhe krajatat shpirtërore që i ka pasur në hartimin e veprës.

Botues i Fjalorit serbisht – shqip është SHB "Logos-A" nga Shkupi, ndërsa redaktor i përgjithshëm i tij është prof. Xhevat Lloshi.


REXHEP ZLLATKU
FJALOR
SERBISHT-SHQIP | SRPSKO-ALBANSKI
REČNIK




INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHP
ИНСТИТУТ ЗА ДУХОВНО И КУ
INSTITUTE OF SPIRITUAL AND

25 tetor 2022

Përdorimi i gjuhëve zyrtare – temë e diskutimit në IN Filarmonia e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, Ylber Sela, e vizitoi Institucionin Nacional Filarmonia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u takua me drejtoreshën Tina Ivanova Bejkov, me të cilën biseduan për bashkëpunimin e këtyre dy institucioneve.

Drejtori Sela iu falënderua koleges së tij për mikpritjen dhe njëkohësisht i ofroi mbështetje me drejtime të sakta rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion të rëndësishëm nacional e kulturor.



Nga ana tjetër, drejtoresha Ivanova Bejkov shprehu vullnetin dhe përgatitjen që ta realizojë detyrimin ligjor, duke theksuar se pret ndihmë dhe bashkëpunim mes dy palëve për realizimin e mëtejmë të suksesshëm të këtij procesi.

Të dyja palët ranë dakord që komunikimi i ndërsjellë do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme për të lehtësuar procesin e harmonizimit të detyrimeve ligjore.

9 nëntor 2022

Prezantimi i e-bazës së rregullave të Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Sot, në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës së RMV-së (AZGJ) përfaqësues të IP Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë mbajtur prezantim të bazës elektronike të rregullave të cilat i disponojnë institucionet publike.

Baza elektronike e rregullave është mjet i dobishëm që do ta lehtësojë punën e përditshme operative të AZGJ-së, me qasje të mundshme deri te arkivi i pasur me akte legjislative, të organizuara në fusha dhe nënfusha, me opsione për kërkim të shpejtë dhe mundësi për qasje deri te redaksia e rregullave me tekste të konsoliduara.





10 nëntor 2022

Konferenca jubilare në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

Më 10 nëntor 2022 u shënua 50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit. Me këtë rast, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (AShSh) organizoi konferencën jubilare, ku ishin ftuar pjesëmarrës të konferencës së atëhershme, por edhe figura të ndryshme të sferës së arsimit e të politikës.

Me ftesë të veçantë të AShSh-së, në këtë konferencë jubilare mori pjesë edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela.





14 nëntor 2022

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në hapjen e Ditëve të Alfabetit 2022

Sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup u hapën Ditët e Alfabetit 2022, ku fjalë rasti mbajtën drejtori i këtij institucioni, Skender Asani, si dhe shumë përfaqësues të tjerë të shoqatave dhe të institucioneve nga vendi dhe nga rajoni.



Para të pranishmëve fjalë rasti mbajti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i cili foli për bashkëpunimin me ITSHKSH-në për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme kombëtare, siç është Kongresi i Alfabetit dhe Kongresi i Drejtshkrimit. Me këtë rast ai foli edhe për nevojën e forcimit të vetëdijes për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe, si dhe për zbatimin e drejtë të saj.

14 nëntor 2022

Janë nënshkruar dy memorandume dhe Programi i bashkëpunimit në kuadër të mbledhjeve dypalëshe ndërmjet qeverive të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë

Të dy memorandumet, të propozuara dhe të përgatitura nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, u nënshkruan nga dr. Jeton Shaqiri, ministër i Arsimit dhe i Shkencës i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dr. Evis Kushi, ministre e Arsimit, e Sportit dhe e Rinisë e Republikës së Shqipërisë.

Memonardumi i parë ka të bëjë me bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Arsimit, të Sportit dhe të Rinisë së Republikës së Shqipërisë, për korrigjimin/redaktimin gjuhësor të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Shqipërisë, ndërkaq memorandumi i dytë ka të bëjë me bashkëpunimin për zbatimin e gjuhës së shenjave shqipe në të dy vendet.



17 nëntor 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela u paraqit me kumtesë në konferencën "Studimet albanologjike në gjuhën gjermane"

Në suaza të Ditëve të Alfabetit, të organizuar nga ITSHKSH-ja në Shkup, sot u mbajt sesioni i tretë i konferencës shkencore "Studimet albanologjike në gjuhën gjermane".

Para të pranishmëve kumtesat e tyre i lexuan Anton Nikë Berisha, Mimoza Kore, Sefer Tahiri etj.



Po ashtu, me kumtesë u paraqit edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela i cili foli për albanologun gjerman, Hanin dhe udhëtimet e tij nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit, duke sjellë një mozaik të dhënash interesante lidhur me disa vendbanime ku jetojnë shqiptarët.

17 nëntor 2022

AZGJ-ja dhe Sekretariati i Legjislacionit e konfirmuan bashkëpunimin e mire

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, e vizitoi Sekretariatin e Legjislacionit, ku zhvilloi takim pune me Liliana Pejçinovska Miladinovskën, sekretare e Sekretariatit të Legjislacionit.

Takimi u zhvillua me kërkesë të drejtorit Sela me qëllim të evidentimit të dobësive gjatë zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e Sekretariatit, shërbimit profesional të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili me funksionin e tij përgjegjës dhe gamën e gjerë të kompetencave është faktor më se i rëndësishëm në sigurimin e konsistencës së sistemit ligjor.

Sekretariati është shembull pozitiv i zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, por megjithatë ka nevojë për krijimin e një ekipi të kuadrit profesional në fushën e përkthimit të terminologjisë profesionale juridike, situatë për të cilën të dyja palët ranë dakord që të ndërmerren hapat e duhur për tejkalimin e saj, në bashkëpunim me institucionet kompetente.

Në fund të takimit të dy bashkëbiseduesit e konfirmuan bashkëpunimin e mirë institucional.



17 nëntor 2022

AZGJ-ja vendosi bashkëpunim me Klinikën e Veshëve, të Hundës dhe të Fytit

Pas vizitës në Sekretariatin e Legjislacionit, drejtori i AZGJ-së realizoi vizitë edhe në ISHP Klinika e Veshëve, e Hundës dhe e Fytit, ku u takua me drejtorin organizativ të saj, z. Ilir Saiti.

Në takim, drejtori Sela shqyrtoi situatën lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Klinikë dhe dorëzoi pako publikimesh të AZGJ-së që i referohen zbatimit praktik të ligjit.

Drejtori organizativ Saiti shprehu vullnet dhe gatishmëri për bashkëpunim me AZGJ-në, duke shpresuar se takimi do të ndihmojë në procesin e zbatimit të obligimeve ligjore.

Të dyja palët e vlerësuan takimin si shumë të dobishëm dhe u pajtuan që dialogu të vazhdojë në drejtim të shkëmbimit të mendimeve dhe bashkëpunimit të thelluar në të ardhmen, në interes të pacientëve si përdorues të shërbimeve shëndetësore të Klinikës.



18 nëntor 2022

Në Shkup u mbajt Festivali “Imazhi Shqiptar”

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGj) u mbajt Festivali Ndërkombëtar i 19-të “Imazhi Shqiptar”.

Ky aktivitet përkon me jubileun e 50-të të Kongresit të Drejtshkrimit dhe atë të 114-të të Kongresit të Manastirit.

Partnerë të organizimit të sivjetmë ishin edhe Instituti i Gjuhës, i Kulturës dhe i Qytetërimit Shqiptar “Josif Bageri” në Universitetin e Tetovës (UT).

Aktiviteti u përshëndet edhe me pjesëmarrjen e rektorit të UT-së, Vullnet Ameti, ndërkaq të pranishmit u pritën nga drejtori i AZGj-së, Ylber Sela i cili u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, ndërkaq ndau disa plakete.

Fjalën e morën edhe rektori i UT-së, Vullnet Ameti, kryetari i Senatit të UT-së, Kushtrim Ahmeti, ideatori i festivalit “Imazhi Shqiptar”, Astrit Memia.

Me motivacionin: “për kontributin e dhënë në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut”, sivjet, çmimin “Ambasador për Imazhin Shqiptar dhe Identitetin Kombëtar”, shoqëruar me statujën “Jam Shqyptar” e mori Risto Qiriazi, pinjoll i familjes Qiriazi ku u mbajt Kongresi i Manastirit.







21 nëntor 2022

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në promovimin e librit të Agim Vincës

Sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup u promovua libri "Saga e shkronjave shqipe" i autorit Agim Vinca, të cilin e botoi Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe ITSHKSH-ja. Para të pranishmëve folën Skender Asani, Avzi Mustafa, Rami Memushaj, si dhe autori Agim Vinca.

Po ashtu, të pranishmit i përshëndeti edhe drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela i cili foli për personalitetin e Agim Vincës.

Në fund, Ylber Sela dhe Skender Asani u ndanë mirënjohje Agim Vincës, Rami Memushajt, Avzi Mustafës dhe Vebi Bexhetit.





23 nëntor 2022

Diskutim për shqipen standarde në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela mori pjesë në debatin e zhvilluar sot në #COD kushtuar shqipes së njësuar, në kuadër të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Tema që u trajtua, ishte "Shqipja standarde te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut", për të cilën folën edhe Valbona Toska, zëvendësdekane në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit, Shezai Rrokaj, përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe anëtar i Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe në ASHSH dhe Tomor Plangarica, kërkues shkencor në Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe profesor i disiplinave gjuhësore dhe letrare në INALCO në Paris.

Në përmbyllje të takimit, drejtori Ylber Sela ndau disa çmime mirënjohjeje për kujdesin ndaj gjuhës shqipe dhe për kontributin e dhënë me anë të organizimit të kësaj veprimtarie për Qendrën për Hapje dhe Dialog, sekretarin shkenxor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Shabani Sinanin, si dhe Emil Lafen e Gjovalin Shkurtajn.









25 nëntor 2022

Fjala e drejtorit të AZGJ-së, prof.dr.Ylber Sela në hapjen e sesionit shkencor të konferencës mbarëkombëtare shkencore "Një komb - një gjuhë" në Tiranë, organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike.

Të nderuar miq!

Është fat i madh të përjetosh ngjarje të këtilla siç është shënimi i 50 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. E quaj fat për arsye se po shënojmë një ngjarje shumë të rëndësishmese kombëtare, e cila sot po i sheh rezultatet e arritura kudo në hapësirat ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët. Kjo do të thotë se u bë një gjysmëshekull që jemi duke komunikuar në nivel kombëtar me një gjuhë të përbashkët standarde, gjuhë kjo e cila sigurisht i ka pasur peripecitë dhe sfidat e veta zhvillimore e praktike. Tani mund të themi me gojën plot se thënia e njohur: "Një komb – një gjuhë – një drejtshkrim", nuk ka qenë një retorikë e zbrazët, por një thënie substanciale e cila na ka obliguar dhe na ka shtyrë që të ecim përpara në të gjitha aspektet kombëtare, duke dëshmuar se jemi një komb I qytetëruar dhe I bashkuar së paku në aspektin gjuëhsor e kulturor. Duke iu përmbajtur këtij slogani, ne kemi arritur këtu ku jemi sot, pavarësiht nga problemet dhe vështirësitë që kemi pasur gjithandej viseve tona, të cilat i kemi tejkaluar me urtësi, vizion e vendosmëri.

Duke qenë në krye të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës Shqipe, si drejtor i saj, natyrisht më ka rënë barra dhe përgjegjësia që të jem pjesë e këtyre proceseve të rëndësishme historike e kombëtare, për arsye se detyrë e këtij institucioni ka qenë dhe vazhdon të jetë zbatimi i gjuhës shqipe në institucionet shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kuptohet në përputhje me normat e standardit të saj. Përkthimi dhe lekturimi i shkresave, i akteve dhe i dokumenteve të ndryshme zyrtare në shqipen standarde, nënkupton përgjegjësinë tonë shumë serioze, angazhimin tonë të vazhdueshëm për ta ngritur këtë gjuhë në nivele të barabarta me maqedonishten.

Siç e dimë, në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, tanimë gjuha shqipe është avancuar dukshëm në aspektin e përdorimit të saj zyrtar. Prandaj, brenda kësaj kornize dhe mundësie ligjore, neve na mbetet si detyrë parësore që ta përdorim atë sa më drejt, ta shkruajmë dhe ta flasim sipas standardit, duke dëshmuar se jemi pjesë e kombit shqiptar, se e ruajmë dhe e kultivojmë atë me të gjitha mundësitë dhe potencialin tonë.

Në fund, dëshiroj të theksoj se në këtë përvjetor të veçantë, edhe ne si AZGJ jemi pjesë e vogël e kësaj tërësie të madhe që ka të bëjë me gjuhën shqipe,

duke u zotuar se do të vazhdojmë dhe më tej të kontribuojmë dhe t'i përmbahemi këtij standardi që i bashkon shqiptarët gjithandej.

Pastë jetë të gjatë standardi i gjuhës shqipe! Qofshim gjithmonë besnikë e të denjë për ta zbatuar atë në praktikë!

Falemnderit!



26 nëntor 2022

Shqipja në Diasporë
TAKIMI MBARËKOMBËTAR PËR GJUHËN SHQIPE NË DIASPORË

Kam nderin dhe kënaqësinë që të përshëndes këtë aktivitet kaq të rëndësishëm që organizohet për gjuhën shqipe në diasporë. Jam shumë i emocionuar pasi edhe unë i përkas diasporës. Jetova e u arsimova në Vjenë. I mbarova tre ciklet e studimit në Universitetin e Vjenës dhe vendosa të kthehem në vendin tim. Nuk ishte vendim i lehtë por sot jam krenar që kam mundësi të punoj për vendim tim dhe për kombin tim me shpresë që edhe të tjerë te rinj të ndjekin rrugën time sepse vendet tona kanë nevoj për trurin e diasporës tonë.

Ne shqiptarët gjatë pjesës së dytë të çdo nëntori kemi shumëçka për të festuar, por sivjet manifestimet e shumta për nder të 50 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit kanë bërë këtë nëntor edhe më të veçantë.

Drejtshkrimi i shqipes standarde është i domosdoshëm në procesin e mësimit të gjuhës sonë, që ta flasim dhe ta shkruajmë të gjithë njësoj, drejt dhe pa gabime.

Gjuha për ne shqiptarët ka rëndësi jetike, përmes shqipes mbetemi shqiptarë, kudo që gjendemi anembanë botës. Ndër shekuj shqipja na ka bashkuar dhe përmes saj kemi ruajtur qenien tonë kombëtare.

Të gjithë e njohim rolin e diasporës shqiptare, ndihmën e saj të vazhdueshme për themelimin e shtetit shqiptar, për shtetin e Kosovës dhe për çështjen shqiptare në përgjithësi. Pjesëtarët e diasporës shqiptare edhe sot e gjithë ditën mbështesin vendlindjen e tyre. Pa këtë ndihmesë të përditshme, jeta në viset tona, në këto kohë krizash, do të ishte edhe më e vështirë.

Por çka bëjmë ne për diasporën shqiptare të shpërndarë kudo dhe të shumtë në numër? A përkujdesemi ne sa duhet për njerëzit tanë që ishin të detyruar që të lëshojnë vendlindjen? Sa jemi të vetëdijshëm për këtë potencial të përbashkët kombëtar? A i ndihmojmë ne ata që të ruajnë gjuhën shqipe, të organizojnë mësim të shqipes në vendet ku ata punojnë e jetojnë?

Mendojë se deri më tani nuk është bërë dhe aq sa duhet. Besoj se së bashku institucionet e vendeve tona mund të mbështesin më fuqishëm në këtë drejtim diasporën shqiptare.

Jam i bindur se ne të gjithë mund të ndihmojmë diasporën tonë në procesin e organizimit të mësimit të shqipes, në sigurimin e librave të duhur për gjuhën shqipe, si dhe përgatitjen e mësimdhënësve të gjuhës.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në Shkup, që nga themelimi në vitin 2019, dhe unë si drejtor i parë i saj, krahas punës parësore që të zbatojmë ligjin e

gjuhëve, të përshpejtojmë përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në RMV, në kuadër të fushatës së ndërgjegjësimit qytetar e kombëtar, përpiqemi që të nxisim dhe të mbështesim edhe mësimin e shqipes në diasporë.

Mendoj se është shumë i rëndësishëm procesi i ndërgjegjësimit të diasporës sonë për rolin vendimtar që ka shqipja në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Diaspora duhet të shfrytëzojë çdo mundësi për të mësuar gjuhën shqipe. Dëgjojmë për ditë që hapen shkolla shqipe në diasporë. Por ankesat dhe vërejta e organizatorëve dhe mësimdhënësve është se, prindërit kanë pak interes për të dërguar fëmijët e tyre nëpër këto shkolla.

Më lejoni që të them ca mendime se sa dobi sjellë mësimi dhe njohja e mirë e gjuhës amtare kudo që të jemi:

- Kur dimë mirë shqipen, si individ kemi më shumë vlerë dhe mundësi shtesë edhe në vendet e huaja.

- Me njohjen e mirë të gjuhës amtare e kemi më të lehtë që të mësojmë edhe gjuhën e vendit si dhe gjuhët botërore.

- Zotërimi i mirë i gjuhës standarde shqipe, çdo shqiptari i lehtëson njohjen e ndërsjellë dhe mundëson bashkëpunim të frytshëm ndër shqiptar.

- Përmes mësimit të mirë të shqipes së shkruar, fëmijët tanë në diasporë, do të mbajnë më lehtë lidhjet me vendlindjen dhe të gjithë viset shqiptare.

Për këtë arsye është më se e domosdoshme që shqipja të flitet në familje, në shoqërimet e përbashkëta, se vetëm kështu mund të ruhet gjuha e mëmëdheut, por edhe identiteti kombëtar shqiptar. Vetëm nëse ruajmë gjuhën shqipe kudo që jemi, mbetemi përherë shqiptarë!

Edhe një porosi për diasporën tonë: flisni me krenari gjuhën shqipe, kudo që keni mundësi; mbështetni dëshirën për të mësuar çdo shqiptarë gjuhën e vet!

Vetëm me këtë ndërgjegjësim, me këto përpjekje dhe me shumë këmbëngulje të çdo prindi për të dërguar detyrimisht fëmijët në shkolla për mësim të gjuhës shqipe; me librin shqip, këngën shqipe në çdo familje shqiptare, mund të ruajmë gjuhën dhe identitetin tonë kombëtar shqiptar.

Shpirti dhe kombi shqiptar ruhen vetëm përmes gjuhës shqipe!

Gëzuar Festën e Flamurit Shqiptar!


SHQIPJA NË DIASPORË


MONDIAL
HOTEL
SHQIPJA NË DIASPORË
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN




MONDIAL
HOTEL
SHQIPJA NË DIASPORË
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

27 nëntor 2022

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela mori pjesë në aktivitetet e festave të nëntorit në Tiranë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela mori pjesë aktive në disa manifestime kulturore e shkencore që u zhvilluan në Tiranë me rastin e festave të nëntorit. Kështu, në ekspozitën "Udha e pavarësisë" e cila u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar, para të pranishmëve ai foli për nënshkruesit e pavarësisë së Shqipërisë nga zona e Strugës dhe e Ohrit.

Po ashtu, ai ishte pjesëmarrës edhe në konferencën shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, të organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, ku foli për rolin dhe angazhimin e AZGj-së në zbatimin e standardit gjuhësor në dokumentet zyrtare në RMV.

Krahas kësaj, me një fjalë përshëndetëse, drejtori Sela u paraqit edhe në manifestimin "Shqipja në diasporë" të organizuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën duke theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe.

7 dhjetor 2022

Politikania Valentina Leskaj vizitoi AZGj-në

Politikania shqiptare, Valentina Leskaj e shoqëruar nga drejtuesit e Shtëpisë Botuese "Toena", Fatmir dhe Irena Toçi dhe nga shkrimtarja Diana Çuli, vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj), me ç'rast u pritën nga drejtori Ylber Sela.

Vizita e tyre përkonte me promovimin e librit të Valentina Leskajt, "Politika si ide", që u mbajt në Shkup.

Gjatë kësaj vizite, mysafirët u interesuan për punën, sfidat dhe të ardhmen e AZGj-së, për të cilat i informoi drejtori, Ylber Sela.





7 dhjetor 2022

Takim ndërinstitucional me Agjencinë e Administratës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela vizitoi Agjencinë e Administratës (AA).

Ai u prit nga drejtori dhe zëvendësdrejtori i AA-së, Spase Gligorov, përkatësisht Agron Seferi.



Kjo vizitë u realizua për të parë nga afër zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe për të parë mundësitë e thellimit të bashkëpunimit.

Palët u dakorduan që të vazhdojnë takimet e këtilla informuese.

13 dhjetor 2022

Vlerësime për veprën më të re të gjuhëtarit, Mustafa Ibrahimit

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) qëndroi gjuhëtari Mustafa Ibrahimi, njëherë edhe bashkëpunëtor e mbështetës i saj.

Ai u prit nga drejtori Ylber Sela dhe të punësuarit e tjerë të kësaj Agjencie.

Me këtë rast, gjuhëtari Ibrahimi i dhuroi Agjencisë botimin e tij më të ri "Folklori dhe etnokultura shqiptare e Pelagonisë".



Veprat e këtilla janë mjaft të rëndësishme sepse paraqesin dëshmi të gjuhës, të kulturës e të traditës shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

15 dhjetor 2022

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve - temë e diskutimit me ministrin Aliti

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, ka vizituar Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ku u takua me ministrin Admirim Aliti.

Në takim u diskutua për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, me theks të veçantë në aktet nënligjore, që i përcakton ministri, ndërsa rrjedhin nga kompetenca e Ministrisë.



Drejtori Sela e njoftoi bashkëbiseduesin për disa gjendje të caktuara, që janë konstatuar në pjesën legjislative, për të cilat është i nevojshëm harmonizimi me ligjin, ndërsa ministri Aliti e shprehu gatishmërinë e tij për bashkëpunim dhe ndërmarrje të hapave të nevojshëm në këtë pjesë.

Të dyja palët e konfirmuan bashkëpunimin e mirë ndërinstitucional, me angazhime për intensifikimin e komunikimit, me qëllim përshtatjen me detyrimet ligjore dhe krijimin e mundësive për zbatimin konsekuent të ligjit.

22 dhjetor 2022

Botime të reja në bibliotekën e AZGJ-së

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) sot qëndroi gjuhëtari Asllan Hamiti njëherë edhe bashkëpunëtor e mbështetës i saj dhe kolegu i tij profesor Ismet Osmani.

Ata u pritën nga drejtori Ylber Sela dhe të punësuar tjerë të kësaj Agjencie.

Me këtë rast, gjuhëtari Hamiti i dhuroi Agjencisë disa botime të tij duke pasuruar bibliotekën e agjencisë.

Veprat e këtilla janë mjaft të rëndësishme sepse paraqesin dëshmi të gjuhës, të kulturës e të traditës shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



REKOMANDIME

- Të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, t'i zbatojnë detyrimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në këtë kontekst, Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve rregullisht dhe në vazhdimësi duhet të kryejë mbikëqyrje inspektuese në raport me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

- Realizimi i detyrimeve, para së gjithash, nënkuptohet ndërtimi i kapaciteteve të kuadrit dhe ato teknike në suazat e organeve (angazhimi i përkthyesve dhe lektorëve të kualifikuar, sigurimin e softuerit të përkthimit etj.) Të gjithë organet në aktin e tyre të sistematizimit dhe organizimit të brendshëm të vendeve të punës, të parashohë forma organizative/vende të punës për përkthyes dhe interpretues në dhe nga gjuha shqipe.

- Të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemit me mungesën e lektorëve të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston institucion kompetent për realizimin e provimit për lektor të gjuhës shqipe dhe lëshimin e licencave për lektorë të gjuhës shqipe.

- Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë, të krijojë politika nëpërmjet të cilave do të rritet atraktiviteti për regjistrim në katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe (drejtimi përkthim dhe interpretim) në institucionet publike të arsimit të lartë (për shembull, nëpërmjet rritjes së kuotave të regjistrimit, ndarjen e bursave të studimit dhe suksesit të arritur, punësimi i garantuar/stazhionimi me prioritet për punësim në sektorin publik etj.)

- Orvatjet e autoriteteve të drejtësisë të drejtohen nga ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve për përdorimin efektiv dhe efikas të gjuhëve në procedurat gjyqësore, administrative, procedurat e përmbarimit, procedurat e ekzekutimit të sanksioneve, procedurat hetimore dhe parahetimore, procedurat penale dhe kundërvajtëse, procedurat Kontestimore dhe jokontestimore, si edhe

procedura të tjera para gjyqeve, prokuroritë publike, si edhe të gjithë organet e tjera të gjyqësisë, trupa dhe institucione.

- Ndërtimi i konceptit të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët medoemos duhet të ketë reflektim në arsim, duke filluar nga ai fillor, nëpërmjet reformave të mësimit të gjuhës së bashkëqytetarit tënd, si mjet kryesor komunikimi, bashkëjetesë dhe kuptim i ndërsjellë.

- Të sigurohet respektim i tërësishëm i detyrimit ligjor të publikimeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" të ligjeve, akteve nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet e pushtetit shtetëror, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj. Akoma nuk kemi respektim të tërësishëm të ligjit nga ky aspekt.

- Të gjithë institucionet kompetente t'i harmonizojnë aktet e veta të brendshme me dispozitat gjuhësore të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

- Institucionet që punojnë nëpërmjet sportelit/pultit, të sigurojnë që personat që punojnë në sportel/pult të kenë njohuri të të dy gjuhëve zyrtare. Vetëm kështu mund të arrihet dhe respektohet dygjuhësia institucionale.

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i intensifikojë aktivitetet e ngritjes së vetëdijes publike, për zbatimin e vendimit ligjor të gjuhëve, si rregull pozitiv ligjor dhe t'i drejtojë aktivitetet e veta nga forcimi i konceptit qytetar të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët.

AZGJ-ja do të vazhdojë edhe më tutje me punën e saj të pandërprerë të jetë një faktor aktiv institucional në aspektin e zbatimit efikas dhe efektiv të kompetencave të veta në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, njëherësh, një vazhdimësi, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



rr. “Filipi i Dytë i Maqedonisë” nr. 11, kati i 3-të
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Ky raport është publikuar në mars të vitit 2023.
I disponueshëm është në maqedonisht, në shqip dhe në anglisht.



Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

